

Illyria Life Sh.a.

PASQYRAT FINANCIARE

PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2018

DHE RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR

PËRMBAJTJA

RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR

PASQYRAT FINANCIARE	1
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	2
PASQYRA E TË ARDHURAVE GJITHËPËRFSHIRËSE	3
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË EKUITET	4
PASQYRA E RRJEDHËS SË PARASË	5 - 30
SHËNIMET PËR PASQYRAT FINANCIARE	31 - 36
SHËNIMET PLOTËSUESE	

RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR

Për dhe menaxhmentin dhe aksionarët e Illyria Life Sh.a

Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Illyria Life Sh.a (“Kompania”), të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar me 31 dhjetor 2018, dhe pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave tjera gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në ekuitet dhe pasqyrën e rrjedhjes së parasë për vitin e përfunduar, bashkangjitur shënimet lidhur me pasqyrat financiare, duke përfshirë një përmbledhje të politikave të rëndësishme kontabël.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Kompanisë më 31 dhjetor 2018 dhe performancën e saj financiare dhe rrjedhën e parasë për vitin e përfunduar në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

Bazat për Opinion

Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve përshkruhen më tej në Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare, pjesë e raportit tonë. Ne jemi të pavarur nga Kompania në pajtim me Kodin e Etikës për Kontabilistët Profesionistë (Kodi IESBA) dhe me kërkesat etike që janë relevante për auditimin tonë të pasqyrave financiare në Kosovë, dhe ne kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë.

Çështje tjetër

Pasqyrat financiare të Kompanisë për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017, janë audituar nga një tjetër auditor, i cili ka shprehur një opinion të pamodifikuar mbi këto pasqyra financiare më 23 shkurt 2018.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të atyre që janë të ngarkuar me Qeverisjen e Pasqyrave Financiare

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SNRF-të dhe për kontrollin e brendshëm që menaxhmenti përcakton se është i domosdoshëm për të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare pa gabime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, menaxhmenti është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së Kompanisë për të vazhduar aktivitetin, duke zbuluar, sipas rastit, çështjet që kanë të bëjnë me vazhdimësinë e biznesit dhe duke përdorur parimin e kontabilitetit për vijimësinë e biznesit, përveç nëse menaxhmenti synon të likujdojë Kompaninë ose të ndërpresë operacionet, ose nuk ka alternativë reale, përveç se ta bëjë atë.

Ata që janë të ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Kompanisë.

Përgjegjësitë e auditorit për auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë që të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare në tërësi janë pa gabime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe për të nxjerrë një raport të auditorit që përfshin opinionin tonë. Sigurimi i arsyeshëm është një nivel i lartë sigurie, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNA-të do të zbulojë gjithmonë gabimet materiale kur ekzistojnë. Keqdeklarimet mund të lindin nga mashtrimet apo gabimet dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose në tërësi, ato në menyrë të arsyeshme pritet që të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Si pjesë e një auditimi në përputhje me ISA, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe mbajmë skepticism profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keqdeklarimeve materiale të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit, hartojmë dhe kryejmë e procedura të auditimit të që i përgjigjen këtyre rreziqeve dhe marrim prova të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të një keqdeklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë se ai që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë fshehje, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keqinterpretime ose shkelje të kontrollit të brendshëm.
- Marrim një kuptim të kontrollit të brendshëm që ka të bëjë me auditimin, me qëllim të hartimit të procedurave të auditimit që janë në përshtatshme me rrethanat, por jo me qëllim të shprehjes së një opinionimi mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Kompanisë.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kontabël dhe shpalosjeve të bëra nga menaxhmenti.
- Konkludojmë në lidhje me përshtatshmërinë e përdorimit të menaxhimit të bazës së vijimësisë të kontabilitetit dhe në bazë të provave të auditimit të fituara, nëse ekziston një pasiguri materiale që lidhet me ngjarjet ose kushtet që mund të shkaktojnë dyshime të konsiderueshme mbi aftësinë e Kompanisë për të vazhduar aktivitetin. Nëse konkludojmë se ekziston një pasiguri materiale, na kërkohet të tërheqim vëmendjen në raportin e auditorit tonë në shpalosjet përkatëse në pasqyrat financiare ose, nëse këto dhënie informacionesh shpjeguese janë jo adekuate, të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në provat e auditimit të fituara deri në datën e raportit të auditorit tonë. Sidoqoftë, ngjarjet ose kushtet e ardhshme mund të shkaktojnë që kompania të pushojë së vazhduari aktivitetin.
- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë dhënien e informacioneve shpjeguese, dhe nëse pasqyrat financiare përfaqësojnë transaksionet dhe ngjarjet në mënyrë që të arrihet një paraqitje e drejtë.

Ne komunikojmë me ata që janë të ngarkuar me qeverisjen, ndër të tjera çështje, fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, duke përfshirë çdo mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që identifikojmë gjatë auditimit tonë.

Deloitte Kosova sh.p.k.
Rr. Lidhja e Pejës, Nr. 177,
Prishtinë, Republika e Kosovës
Nr. unik identifikues: 810468373
19 shkurt 2019



Partnere e angazhimit:
Arta Limani

ILLYRIA LIFE Sh.a
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR
Më 31 dhjetor 2018

(vlerat në Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

	Shënime	2018	2017
Pasuritë			
Paraja dhe ekuivalentët e parasë	8	1,045,682	564,050
Depozitat e afatizuara	9	838,994	3,733,673
Letrat me vlerë	9	8,376,455	6,064,471
Pjesa e risiguruesve për detyrimet e siguruar	10	25,321	18,393
Prona, impiantet dhe pajisjet, neto	11	522,491	531,247
Pasuri të tjera	12	142,448	1,787,764
Gjithsej pasuritë		10,951,392	12,699,598
Detyrimet			
Detyrimet për humbjet dhe shpenzimet e rregullimit të humbjes	13	5,806,094	5,012,095
Rezerva e primeve të pa fituara	14	220,894	221,568
Të ardhurat e shtyra	15	16,571	54,046
Huatë	17	-	3,005,927
Detyrime të tjera	16	220,600	209,235
Gjithsej detyrimet		6,264,159	8,502,871
Ekuiteti			
Kapitali aksionar	18	3,285,893	3,285,893
Rezerva e vlerës së drejtë		691,193	416,356
Fitimet e mbajtura		394,478	263,628
Fitimi i vitit aktual		315,669	230,850
Gjithsej ekuiteti		4,687,233	4,196,727
Gjithsej detyrimet dhe ekuitetit		10,951,392	12,699,598

Pasqyrat financiare të paraqitura në faqet 1 deri në 30 u miratuan për publikim më 15 shkurt 2019.

Albin Podvorica

Drejtor Gjeneral



Zamira Ibrahim

Udhëheqëse e Kontabilitetit dhe
Financave

Shënimet nga faqe 5 deri 30 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

ILLYRIA LIFE Sh.a
PASQYRA E TË ARDHURAVE GJITHËPËRFSHIRËSE
Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2018
 (vlerat në Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

	Shënime	2018	2017
Primet e shkruara bruto	19	2,096,721	1,708,366
Tatimi në prime	19	(104,836)	(85,418)
Ndryshimi në provizionin bruto për primet e pa fituara	14	674	(6,115)
Primet e shkruara neto		1,992,559	1,616,833
Primet e ceduara ndaj risiguruesve	20	(55,264)	(35,822)
Pjesa e risiguruesve në ndryshimin e provizionit për primet e pafituara	10	6,928	955
Të ardhurat neto nga primet e sigurimit		1,944,223	1,581,966
Të ardhurat nga investimet		316,189	197,799
Të ardhurat tjera	23	-	167,888
Shpenzimet e interesit		(18,552)	(6,700)
Tatimi në të ardhurat nga interesi		(8,482)	(9,877)
Pjesa e risiguruesve në dëmet e paguara		-	30,113
Komisioni i risigurimit	21	8,176	5,661
Gjithsej të ardhurat		2,241,554	1,966,850
Humbjet dhe shpenzimet e rregullimit të humbjeve	13	(793,998)	(646,352)
Shpenzimet e marrjes në sigurim	22	(271,080)	(229,953)
Shpenzimet e dëmeve	13	(450,046)	(542,541)
Shpenzimet administrative	24	(410,761)	(317,154)
Gjithsej humbjet dhe shpenzimet		(1,925,885)	(1,736,000)
Fitimi neto për vitin		315,669	230,850
<i>Të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse</i>			
Të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse/Rivlerësimi i letrave me vlerë në dispozicion për shitje		274,837	413,164
<i>Gjithsej të ardhurat gjithëpërfshirëse për vitin</i>		590,506	644,014

Shënimet nga faqe 5 deri 30 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

ILLYRIA LIFE Sh.a
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË EKUITET
Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2018
(vlerat në Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

	Kapitali aksionar	Fitimet e mbajtura	Të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse	Gjithsej
Gjendja më 1 janar 2017	3,285,893	363,628	3,192	3,652,713
<i>Të ardhurat gjithëpërfshirëse për vitin</i>				
Fitimi neto i periudhës	-	230,850	-	230,850
Fitimi nga rivlerësimi i letrave me vlerë në dispozicion për shitje	-		413,164	413,164
Gjithsej të ardhurat gjithëpërfshirëse	-	594,478	416,356	644,014
Dividenda e paguar	-	(100,000)	-	(100,000)
Gjithsej transaksionet me aksionarët të raportuara direkt në ekuitet	-	(100,000)	-	(100,000)
Gjendja më 31 dhjetor 2017	3,285,893	494,478	416,356	4,196,727
Gjendja më 1 janar 2018	3,285,893	494,478	416,356	4,196,727
<i>Të ardhurat gjithëpërfshirëse për vitin</i>				
Fitimi neto i periudhës	-	315,669	-	315,669
Fitimi nga rivlerësimi i letrave me vlerë në dispozicion për shitje	-	-	274,837	274,837
Gjithsej të ardhurat gjithëpërfshirëse	-	315,669	274,837	590,506
Dividenda e paguar	-	(100,000)	-	(100,000)
Gjithsej transaksionet me aksionarët të raportuara direkt në ekuitet	-	(100,000)	-	(100,000)
Gjendja më 31 dhjetor 2018	3,285,893	710,147	691,193	4,687,233

Shënimet nga faqe 5 deri 30 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

ILLYRIA LIFE Sh.a
PASQYRA E RRJEDHËS SË PARASË
Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2018
 (vlerat në Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

	Shënime	2018	2017
Rrjedha e parasë nga aktivitetet operative			
Fitimi neto i periudhës		315,669	230,850
<i>Rregullime për:</i>			
Zhvlerësimi dhe amortizimi	11	14,197	17,691
Rritja në humbjet dhe detyrimet e sigurimit për rregullimet e	13	735,420	646,352
Rritja e detyrimeve të sigurimit për primet e pa fituara	14	(674)	6,115
Shpenzimet e tatimit mbi prime		107,216	85,418
Shpenzimet e interesit		8,482	5,927
Të ardhurat nga investimi, neto		(307,708)	(187,922)
Rrjedha e parasë nga aktivitetet operative para ndryshimeve në pasuritë dhe detyrimet operative		872,602	804,431
<i>Ndryshimet në pasuritë dhe detyrimet operative</i>			
Rritja e pjesës së risiguruesve për detyrimet e sigurimit	11	6,928	955
Rritja/(zvogëlimi) në pasuritë tjera, duke përfshirë interesin e përllogaritur	12	1,690,246	(1,119,582)
(Zvogëlimi) /Rritja në të ardhurat e shtyra	15	(37,475)	26,572
(Zvogëlimi)/ Rritja në detyrimet e tjera, duke përfshirë tatimin mbi primet të pagueshëm	16	(11,365)	73,953
Rrjedha e parasë e gjeneruar nga aktivitetet operative		2,520,936	(213,671)
Tatimi mbi primet, i paguar		(99,102)	(86,094)
Paraja neto e gjeneruar nga aktivitetet operative		2,421,834	(299,765)
Rrjedha e parasë nga aktivitetet investuese			
Blerja e pasurive fikse	11	(5,441)	(5,617)
Zvogëlimi në depozitat e afatizuar	9	2,850,000	90,000
Rritja në borxh dhe letrat me vlerë me të hyra fikse	9	(2,037,147)	(2,779,888)
Interesi i pranuar		352,386	120,631
Paraja neto nga aktivitetet investuese		1,159,798	(2,574,874)
Rrjedha e parasë nga aktivitetet financuese			
Dividenda e paguar		(100,000)	(100,000)
Huatë	17	(3,000,000)	3,000,000
Paraja neto nga aktivitetet financuese		(3,100,000)	2,900,000
Rritja/(zvogëlimi) i parasë dhe ekuivalentëve të parasë		481,632	25,361
Paraja dhe ekuivalentët e parasë në fillim të vitit	8	564,050	538,689
Paraja dhe ekuivalentët e parasë më 31 dhjetor	8	1,045,682	564,050

Shënimet nga faqe 5 deri 30 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

1. NJËSIA RAPORTUESE

Illyria Life Sh.a. (më parë "Dukagjini Life", prej këtu e tutje "Illyria Life" ose "Kompania") është kompani aksionare e regjistruar nga Agjensionit për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë më 28 gusht 2008. Illyria Life është kompania e parë e sigurimit të jetës e licencuar në Kosovë dhe u themelua nën rregulloren 2001/25 të UNMIKUT dhe rregulloren 31 të Bankës Qendrore së Kosovës për licencimin e kompanive të sigurimit të jetës në Kosovë.

Kompania është kompani bijë në pronësi të plotë nga Sava Re Group, kompani sllovene që është e pranishme në Kosovë përmes K.S. Illyria, sh.a.dhe K.S.J. Illyria Life, Sh.a.

Kompania zhvillon veprimtarinë nga ndërtesa me lokacion në Bulevardin Nëna Tereza, nr. 33, Prishtinë, Kosovë. Më 31 dhjetor 2018, Kompania kishte 57 të punësuar duke përfshirë edhe menaxhmentin e lartë (2017: 67).

2. BAZA E PËRGATITJES

a. Deklarata e përputhshmërisë

Pasqyrat financiare shoqëruese janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

Në mungesë të udhëzimeve specifike sipas SNRF-ve në lidhje me trajtimin kontabël të transaksioneve të sigurimit, Kompania ka konsideruar kërkesat dhe udhëzimet në Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar që kanë të bëjnë me çështje të ngjashme dhe relevante; definicionet, kriteret për matjen dhe njohjen e pasurive, detyrimeve, të hyrave dhe shpenzimeve të paraqitura në kornizën e BSNK-së; dhe prononcimet e përpiluesve të tjerë të standardeve dhe praktikave të pranura në industri, siç parashihet në SNK 1. Në veçanti, Kompania i është referuar kërkesave të matjes dhe njohjes së SNRF 4 Kontrata e Sigurimit për udhëzim. Kompania ka vazhduar të përdorë baza statutores (në përputhje me rregullat e miratuara nga Banka Qendrore e Kosovës ("BQK"), rregullatori i saj kryesor) për të regjistruar kontratat e sigurimeve, të ndryshuara sipas kërkesave specifike të SNRF 4 në lidhje me mjaftueshmërinë e detyrimeve dhe risigurimit.

b. Baza e matjes

Këto pasqyra financiare janë përgatitur nën parimin e kostos historike, përveç instrumenteve financiare në dispozicion për shitje, të cilat janë matur me vlerën e drejtë.

c. Valuta funksionale dhe e prezantimit

Pasqyrat financiare janë prezantuar në Euro ("Euro") e cila është valuta funksionale dhe prezantuese e Kompanisë.

d. Gjykimet kritike në aplikimin e politikave kontabël dhe burimet kryesore në vlerësimin e pasigurisë

Përgatitja e pasqyrave financiare në përputhje me SNRF kërkon që menaxhmenti të bëjë gjykime, vlerësime dhe supozime që ndikojnë në zbatimin e politikave dhe shumave të raportuara të pasurive dhe detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Vlerësimet dhe supozimet e ndërlidhura bazohen në përvojën historike dhe faktorët e ndryshëm që besohet të jenë të arsyeshëm në rrethanat, rezultatet e të cilave formojnë bazën për të bërë gjykime në lidhje me vlerat kontabël të pasurive dhe detyrimeve të cilat nuk janë lehtësisht të dukshme nga burimet tjera. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga këto vlerësime. Vlerësimet dhe supozimet themelore shqyrtohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimi i vlerësimeve kontabël njihet në periudhën në të cilën vlerësimi rishikohet nëse rishikimi ndikon vetëm në atë periudhë ose në periudhën e rishikuar dhe periudhat e ardhshme nëse ndryshimi ndikon të dy periudhat aktuale dhe të ardhmen.

2. BAZA E PËRGATITJES (Vazhdim)

d. Gjykimet kritike në aplikimin e politikave kontabël dhe burimet kryesore në vlerësimin e pasigurisë (vazhdim)

Njohja dhe matja e detyrimeve të sigurimit, rezervave teknike

Shënimet 12 dhe 13 dhe shënimi përkatës i politikës kontabël 3.c (i) përmbajnë informacione në lidhje me supozimet dhe paqartësitë që lidhen me detyrimet e sigurimit.

Vlerësimet më të rëndësishme në pasqyrat financiare të Kompanisë lidhen me provizionet teknike. Kompania ka një qasje të arsyeshme dhe të matur ndaj provizionimit. Menaxhmenti beson se niveli aktual i rezervave teknike është i mjaftueshëm.

Humbjet nga rënia në vlerë e të arkëtueshmeve

Kompania rishikon sigurimin e saj për të vlerësuar rënien në vlerë në baza vjetore. Në përcaktimin nëse një humbje nga rënia në vlerë duhet të regjistrohet në fitim ose humbje, Kompania bën gjykime nëse ka të dhëna të vëzhgueshme që tregojnë se ka një ulje të matshme në rrjedhat e ardhshme të parashikuara të parasë nga një grup i të arkëtueshmeve përpara se ulja të mund të identifikohet për një debitor individual në atë portfolio. Kjo dëshmi mund të përfshijë të dhëna të vëzhgueshme që tregojnë se ka pasur një ndryshim të pafavorshëm në statusin e pagesave të debitorit që ndërlidhet me dështimet e pasurive në grup. Menaxhmenti përdor vlerësime të bazuara në përvojën historike të humbjes për pasuritë me karakteristika të riskut kreditor dhe dëshmitë objektive të rënies në vlerë të ngjashme me ato të portfolios gjatë caktimit të rrjedhave të ardhshme të parasë.

3. POLITIKAT E RËNDËSISHME KONTABËL

a. Transaksionet në valutë të huajë

Transaksionet në valutë të huaj, nëse ka, janë transaksione të ndërmarra nga Kompania në valuta tjera nga ajo funksionale. Transaksionet në valutë të huaj janë konvertuar në valutën funksionale me kursin e këmbimit valutor në datën e transaksionit. Pasuritë dhe detyrimet monetare të shprehura në valuta të huaja janë konvertuar në Euro me kursin e këmbimit valutor në datën e raportimit. Diferencat e kursit të këmbimit që rrjedhin nga konvertimi njihen në fitim ose humbje. Pasuritë dhe detyrimet jo-monetare që maten në terma të kostos historike në një valutë të huajë janë konvertuar duke përdorur kursin e këmbimit në datën e transaksioneve.

b. Klasifikimi i kontratave të sigurimit dhe të investimeve (detyrimet)

Kontratat sipas të cilave Kompania pranon risk të rëndësishëm të sigurimit nga një palë tjetër (mbajtësi i policës) duke rënë dakord të kompensojë mbajtësin e policës ndaj një ngjarje të caktuar të pasigurt në të ardhmen (ngjarja e siguruar), e cila ndikon negativisht në të siguruarin, klasifikohen si kontrata të sigurimit. Risku i sigurimit është risku i ndryshëm nga risku financiar. Risku financiar është risku i një ndryshimi të mundshëm të ardhshëm në një ose më shumë të specifikuara: norma e interesit, çmimi i letrave me vlerë, çmimi i mallrave, kursi i këmbimit, indeksat e çmimeve ose normave, vlerësimi i kredisë ose indeksi i kredisë ose ndryshore tjera, të ofruara ne rastet e një ndryshoreje jo-financiare kur ndryshoreja nuk është specifike për një palë në kontratë.

Kontratat sipas të cilave transferimi i riskut të sigurimit tek Kompania nga mbajtësi i policës nuk është i rëndësishëm, klasifikohen si kontrata investimi. Të gjitha kontratat aktualisht të lëshuara nga Kompania përfshijnë transferimin e riskut të rëndësishëm të sigurimit.

3. POLITIKAT E RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

c. Kontratat e sigurimit (detyrimet)

i. Njohja dhe matja

Kontratat e përgjithshme të sigurimit

Detyrimet e sigurimit llogariten ndaras për të gjitha produktet e sigurimit dhe përbëhen nga primet kontingjente (të pa fituara), risku kontingjent (i pa skaduar) dhe humbjet kontingjente (të pa paguara në datën e përfundimit të vitit financiar). Detyrimet e sigurimit (provizionet) përfaqësojnë vlerësimet e pagesave të ardhshme për dëmet e raportuara dhe të pa raportuara. Kompania nuk skonton detyrimet e saj të sigurimit. Çdo ndryshim në vlerësime reflektohet në rezultatet e operacioneve në periudhën në të cilën vlerësimet janë ndryshuar. Vlerësimi i detyrimeve të sigurimit është një proces kompleks që merret me pasigurinë, duke kërkuar përdorimin e vlerësimeve dhe gjykimeve të informuara.

Të hyrat

Primet bruto për kontratat e sigurimit regjistrohen në bazë të primit të shkruar dhe llogariten në fitime në mënyrë proporcionale gjatë periudhës së mbulimit të policës përkatëse. Primi i shkruar bruto pasqyron primin e shkruar gjatë vitit dhe përfshinë tatimet ose detyrimet e aplikueshme në bazë të primeve. Primet fitohen nga data e lidhjes së riskut, mbi periudhën e zhdëmtimit, bazuar në modelin e risqeve të pranuar.

Primet e pa fituara

Provizioni për primet e pa fituara përfshinë pjesën e primeve të shkruara bruto, e cila vlerësohet që do të fitohet në vitin në vijim ose në vitet pasuese financiare, e llogaritur ndaras për secilën kontratë sigurimi duke përdorur bazën proporcionale.

Dëmet (rregullimet e humbjeve)

Dëmet e ndodhura përfshijnë kostot e zgjidhjes dhe të trajtimit të dëmeve të paguara dhe të papaguara që rrjedhin nga ngjarjet e ndodhura gjatë vitit financiar së bashku me rregullimet e provizioneve të dëmeve të vitit të kaluar.

Dëmet e papaguara vlerësohen duke rishikuar kërkesat individuale dhe duke bërë lejime për dëmet e shkaktuara por jo të raportuara, efektin e ngjarjeve të parashikueshme të brendshme dhe të jashtme, siç janë ndryshimet në procedurat e trajtimit të dëmeve, inflacioni, trendet gjyqësore, ndryshimet legjislative si dhe përvoja dhe trendet e kaluara. Provizionet për dëmet e papaguara nuk zbriten. Rregullimet për provizionet e dëmeve të vendosura në vitet e mëparshme janë paraqitur në pasqyrat financiare të periudhës në të cilën rregullimet janë bërë dhe shpalosen ndaras nëse janë materiale.

Përderisa Bordi i Drejtorëve konsideron se detyrimet e sigurimit për dëmet dhe kthimet e risigurimit përkatës janë shprehur në mënyrë të drejtë, detyrimi përfundimtar mund të ndryshojë si rezultat i informacionit dhe ngjarjeve të mëvonshme dhe mund të rezultojë në rregullime të rëndësishme për shumat e dhëna. Rregullimet në shumat e detyrimeve të sigurimit paraqiten në pasqyrat financiare për periudhën në të cilën bëhen rregullimet.

Provizioni i sigurimit të jetës është llogaritur nga aktuari i Kompanisë, duke pasur parasysh parimet e përcaktuara në rregulloren për llogaritjen e provizioneve matematikore për siguresit e jetës, të miratuara nga Rregullatori i Sigurimeve.

3. POLITIKAT E RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

c. Kontratat e sigurimeve (detyrimet) (vazhdim)

ii. Pasuritë e risiguruara

Kompania heq dorë nga primet dhe risku i sigurimit në rrjedhën normale të biznesit me humbje potenciale neto nëpërmjet diversifikimit të riskut të saj. Pasuritë dhe detyrimet që rrjedhin nga kontratat e ceduara të risigurimit paraqiten ndaras si pasuri dhe detyrime nga kontratat e lidhura të sigurimit, sepse marrëveshjet e risigurimit nuk e lirojnë Kompaninë nga detyrimi i drejtpërdrejtë ndaj mbajtësve të policave së saj. Politika e risigurimit të Kompanisë është themeluar me qëllim që të kufizojë humbjet e mundshme që rrjedhin nga ekspozimet më të gjata të policave të sigurimit të jetës. Një risigurim i tillë përfshinë të gjitha policat e sigurimit mbi kufijtë e caktuar të shumave të siguruara.

Primet e risigurimit për risigurimin e ceduar njihen si shpenzim mbi një bazë që është në përputhje me bazën e njohjes së primeve për kontratat e lidhura të sigurimit. Për biznesin e përgjithshëm të sigurimit, primet e risigurimit shpenzohen gjatë periudhës për të cilën ofrohet mbulimi i risigurimit duke u bazuar në modelin e riskut të risigurimit. Pjesa e pa shpenzuar e primeve të risigurimeve të ceduara përfshihet në pasuritë e risigurimit. Shumat e njohura si pasuri të risigurimit maten në baza që janë në përputhje me matjen e provizionit të mbajtur në lidhje me kontratat e lidhura të sigurimit.

Të arkëtueshmet e risigurimeve përfshijnë komisionin e risigurimit në lidhje me primet e ceduara ndaj risiguruesit. Këto klasifikohen si të arkëtueshme dhe shpalosen ndaras, nëse ka.

Pasuritë e risigurimit vlerësohen për rënie në vlerë në çdo datë raportimi. Një pasuri konsiderohet e rënë në vlerë nëse ka prova objektive, si rezultat i një ngjarjeje që ka ndodhur pas njohjes së saj fillestare, që Kompania nuk mund ta mbulojë të gjitha shumat e pa paguara dhe se ngjarja ka një ndikim të matshëm në shumat që Kompania do të arkëtojë.

iii. Të arkëtueshmet dhe të pagueshmet e sigurimeve

Shumat e pagueshme dhe të arkëtueshme ndaj dhe nga mbajtësit e policave, agjentët dhe risiguruesit janë instrumente financiare dhe përfshihen në llogaritë e arkëtueshme dhe të pagueshme të sigurimit si dhe nuk janë në provizionet e kontratave të sigurimit apo pasuritë e risigurimit.

d. Instrumentet financiare

Njohja

Kompania fillimisht njeh kreditë, paradhëniet dhe depozitat në datën kur ato krijohen. Të gjitha pasuritë dhe detyrimet e tjera financiare njihen fillimisht në datën e tregtimit në të cilën Kompania bëhet palë në dispozitat kontraktuale të instrumentit.

Klasifikimi

Shih politikat kontabël 3. (e), (f) dhe (g).

Ç'regjistrimi

Kompania ç'regjistron një pasuri financiare kur skadojnë të drejtat kontraktuale të rrjedhës së parasë nga pasuria ose transferon të drejtat e pranimit të rrjedhave kontraktuale të parasë mbi pasurinë financiare në një transaksion, në të cilin kryesisht të gjitha risqet dhe përfitimet e pronësisë së pasurisë financiar janë transferuar. Çdo interes në pasuritë financiare të transferuara që krijohet ose mbahet nga Kompania, njihet si një pasuri ose detyrim i veçantë.

Kompania ç'regjistron një detyrim financiar kur detyrimet e saj kontraktuale shkarkohen, anulohen ose skadojnë.

Kompania hyn në transaksione përmes të cilave transferon pasuritë e njohura në pasqyrën e pozicionit financiar, por ruan të gjitha apo një pjesë të risqeve ose përfitimeve të pasurive të transferuara.

3. POLITIKAT E RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

d. Instrumentet financiare (vazhdim)

Nëse të gjitha ose kryesisht të gjitha risqet dhe përfitimet mbahen, atëherë pasuritë e transferuara nuk ç'regjistrohen. Transferet e pasurive me mbajtjen e të gjitha ose kryesisht të gjitha risqeve dhe përfitimeve përfshijnë, për shembull, huazimet e letrave me vlerë dhe transaksionet e riblerjes.

Netimi

Pasuritë dhe detyrimet financiare netohen dhe shuma neto paraqitet atëherë dhe vetëm atëherë kur Kompania ka të drejtën ligjore për të netuar shumat dhe tenton t'i zgjidh ato në baza neto ose të realizoj pasurinë dhe të paguajë detyrimin njëkohësisht.

Të ardhurat dhe shpenzimet paraqiten në baza neto vetëm kur lejohet nga standardet e kontabilitetit, ose për fitimet dhe humbjet që rrjedhin nga një grup i transaksioneve të ngjashme siç është aktiviteti tregtar i Kompanisë.

Matja e kostos së amortizuar

Kostoja e amortizuar e një pasurie ose detyrimi financiar është shuma në të cilën pasuria ose detyrimi financiar matet në njohjen fillestare, minus pagesat e principalit, plus ose minus amortizimin e akumuluar duke përdorur metodën e interesit efektiv të ndonjë difference midis shumës fillestare të njohur dhe shumës së maturimit, minus ndonjë reduktim për rënie në vlerë.

Matja e vlerës së drejtë

Përcaktimi i vlerave të drejta të pasurive dhe detyrimeve financiare bazohet në çmimet e kuotuar të tregut ose në kuotat e çmimeve të ndërmjetësve për instrumentet financiare të tregtuara në tregjet aktive. Për të gjitha instrumentet e tjera financiare, vlera e drejtë përcaktohet duke përdorur teknikat e vlerësimit. Teknikat e vlerësimit përfshijnë teknikat e vlerës aktuale neto, metodën e skontuar të rrjedhës së parasë, krahasimin me instrumentet e ngjashme për të cilat ekzistojnë çmimet e vëzhgueshme të tregut dhe modelet e vlerësimit.

Identifikimi dhe matja e rënies në vlerë

Në çdo datë raportimi, Kompania vlerëson nëse ka dëshmi objektive që pasuritë financiare janë kanë pësuar rënie në vlerë. Pasuritë financiare kanë rënie në vlerë kur dëshmitë objektive tregojnë se një ngjarje humbjeje ka ndodhur pas njohjes fillestare të pasurisë dhe se ngjarja e humbjes ka një ndikim në rrjedhën e ardhshme të parasë së pasurisë që mund të matet me besueshmëri.

Kompania konsideron dëshmitë e rënies në vlerë në pasuritë individuale dhe në nivel kolektiv. Të gjitha pasuritë financiare individualisht të rëndësishme vlerësohen për rënie të veçantë në vlerë. Të gjitha pasuritë e rëndësishme që nuk janë të rëna në vlerë në mënyrë të veçantë, vlerësohen kolektivisht për ndonjë rënie në vlerë që ka ndodhur por nuk është identifikuar ende. Pasuritë që nuk janë individualisht të rëndësishme vlerësohen kolektivisht për rënie në vlerë duke grupuar së bashku pasuritë financiare (të bartura me koston e amortizuar) me karakteristika të ngjashme të riskut.

Dëshmitë objektive që pasuritë financiare janë të rëna në vlerë mund të përfshijnë mospagimin ose mos zbatimin e marrëveshjes nga një debitor, ristrukturimin e një kredie ose paradhënie nga Kompania, sipas kushteve që Kompania nuk do t'i konsideronte në rrethana të tjera, treguesit se një debitor do të hyjë në falimentim të kompanisë ose të dhëna tjera të vëzhgueshme në lidhje me një grup të pasurive të tilla si ndryshimet e pafavorshme në statusin e pagesave të huamarrësve apo emetuesve në grup, ose kushtet ekonomike që lidhen me dështimin në grup.

e. Paraja dhe ekuivalentët e parasë

Paraja dhe ekuivalentët e parasë përbëhen nga balancat në para të gatshme, depozitat me para të gatshme me bankat dhe investimet afatshkurtra me likuiditet të lartë me afat maturimi prej tre muajsh ose më pak prej kur ato janë blerë.

3. POLITIKAT E RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

f. Depozitat e afatizuara

Depozitat e afatizuara deklarohen në shumën e principalit të papaguar dhe klasifikohen sipas maturimeve të tyre. Depozitat e afatizuara me afat maturimi më pak se tre muaj klasifikohen si ekuivalentë të parasë, ato me afat maturimi më të madh se tre muaj klasifikohen si depozita të afatizuara. Interesi llogaritet në bazë akruale dhe interesi i arkëtueshëm reflektohet në pasuritë tjera.

g. Të arkëtueshmet e tjera

Të arkëtueshmet e tjera deklarohen me kostot e tyre minus humbjet nga rënia në vlerë (shih politikën kontabël 3.d.vii).

h. Prona, impiantet dhe pajisjet

Prona dhe pajisjet me përjashtim të ndërtesave njihen fillimisht në kosto, duke përfshirë koston që i atribuohet drejtpërdrejtë blerjes së pasurisë. Më pas aplikohet modeli i koston: pasuritë barten me kosto, minus zhvlerësimi i akumuluar dhe humbjet nga rënia në vlerë.

Prona dhe pajisjet zhvlerësohen së pari sipas disponueshmërisë së tyre për përdorim. Zhvlerësimi llogaritet për çdo zë veç e veç, në bazë të linjës së drejtë. Normat e zhvlerësimit përcaktohen në mënyrë që të lejojnë shlyerjen e koston së pronës dhe pajisjeve përgjatë jetëgjatësisë së tyre të vlerësuar.

Ndërtesat

Ndërtesat barten me vlerën e rivlerësuar, vlera e drejtë e të cilave matet në mënyrë të besueshme dhe paraqet vlerën e drejtë në datën e rivlerësimit minus çdo zhvlerësim i akumuluar pasues dhe humbje pasuese e akumuluar nga rënia në vlerë. Rivlerësimet kryhen në baza të rregullta, çdo dy vite.

Zhvlerësimi dhe amortizimi

Zhvlerësimi dhe amortizimi për të gjitha kategoritë e pasurive fikse llogaritet në bazë të metodës lineare përgjatë jetëgjatësisë së vlerësuar të pasurive. Normat vjetore të zhvlerësimit janë:

Ndërtesat dhe lokalet	1.30%
Pajisjet kompjuterike	33.33%
Pajisjet e zyrës dhe mobilje të tjera	10%
Pajisje të tjera	20%
Softuerët	20%

Kompania vlerëson çdo vit nëse ka ndonjë tregues të rënies në vlerë. Nëse ka, fillon procesin e vlerësimit të shumës së rikuperueshme. Shuma e rikuperueshme është vlera më e lartë në mes të vlerës në përdorim dhe vlerës së drejtë minus kostot e shitjes.

Nëse shuma e rikuperueshme tejkalon ose është e barabartë me vlerën kontabël, pasuria nuk ka rënë në vlerë.

Fitimet dhe humbjet nga shlyerjet e zërave të pronës dhe pajisjeve, të llogaritura si diferenca midis të ardhurave të shitjes dhe vlerave kontabël neto, përfshihen në fitim ose humbje. Kostot e mirëmbajtjes dhe riparimit të pronës dhe pajisjeve njihen në fitim ose humbje kur ato ndodhin. Investimet në prona dhe pajisjet që rrisin përfitimet ekonomike të ardhshme njihen në vlerën e tyre kontabël.

3. POLITIKAT E RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

i. Rënia në vlerë e pasurive jo-financiare

Vlera kontabël e pasurive jo-financiare të Kompanisë rishikohet në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka ndonjë tregues të rënies në vlerë. Nëse ekziston ndonjë tregues i tillë pastaj vlerësohet shuma e rikuperueshme e pasurisë.

Një humbje nga rënia në vlerë njihet nëse vlera kontabël e një pasurie ose njësie gjeneruese e parasë tejkalon shumën e rikuperueshme. Një njësi gjeneruese e parasë është grupi më i vogël i identifikueshëm i pasurive që gjeneron para, që janë kryesisht të pavarura nga pasuritë dhe grupet e tjera. Humbjet nga rënia në vlerë njihen në fitim ose humbje.

Shuma e rikuperueshme e një pasurie ose njësie gjeneruese e parasë është vlera më e madhe në mes të vlerës së saj në përdorim dhe vlerës së saj të drejtë minus kostot e shitjes. Në vlerësimin e vlerës në përdorim, rrjedha e ardhshme e vlerësuar e parasë zbritet në vlerën e saj aktuale duke përdorur një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën kohore të parasë dhe risqet specifike të pasurisë.

j. Provizioni

Një provizion njihet kur Kompania ka një detyrim legal ose konstruktiv si rezultat i një ngjarjeje të shkuar dhe është e mundur që një dalje e përfitimeve ekonomike të kërkohej për të shlyer detyrimin.

Provizionet përcaktohen duke zbritur rrjedhat e ardhshme të parasë në normën para tatimit. Provizioni reflekton vlerësimet aktuale të tregut për vlerën kohore të parasë dhe, kur është e përshtatshme, risqet specifike për detyrimin.

k. Njohja e të hyrave

Primi i fituar nga kontratat e sigurimit

Politikat kontabël për njohjen e të hyrave nga kontratat e sigurimit shpalosen në shënimin 3.c. (i).

Të hyrat nga investimet

Të hyrat nga investimet përfaqësojnë të hyra nga pasuritë financiare dhe njihen në fitim ose humbje duke përdorur metodën e interesit efektiv. Norma efektive e interesit është norma që saktësisht zbret pagesat dhe arkëtimet e ardhshme në para përgjatë jetëgjatësisë së pritshme të pasurisë ose detyrimit financiar (ose, sipas rastit, në një periudhë më të shkurtër) në vlerën kontabël të pasurisë ose detyrimit financiar. Norma efektive e interesit përcaktohet në njohjen fillestare të pasurisë dhe detyrimit financiar dhe nuk rishikohet më pas.

l. Përfitimet e punonjësve

Kontributet e detyrueshme pensionale

Kompania paguan vetëm kontributet e detyrueshme pensionale që ofrojnë përfitime pensionale për punonjësit pas daljes në pension. Kontributet e kompanisë në planin pensional ngarkohen në fitim ose humbje kur ato ndodhin.

m. Shpenzimet e marrjes në sigurim

Shpenzimet e marrjes në sigurim përcaktohen si kosto që rrjedhin nga marrja e kontratave të sigurimit, duke përfshirë kostot direkte, siç janë komisionet e marrjes në sigurim dhe kostot e hartimit të dokumentit të sigurimit, si dhe shpenzimet e ndara administrative lidhur me përpunimin e propozimeve dhe lëshimin e policave. Shpenzimet e marrjes në sigurim njihen kur ndodhin.

n. Qiratë

Qiratë në të cilat një pjesë e konsiderueshme e risqeve dhe përfitimeve të pronësisë mbahen nga qiradhënësi klasifikohen si qira operative. Pagesat e bëra sipas qirasë operative janë ngarkuar në fitim ose humbje në bazë lineare përgjatë periudhës së qirasë.

3. POLITIKAT E RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

o. Tatimi mbi fitim

Në përputhje me Ligjin e Kosovës për Tatimin në të Ardhurat e Korporatave nr. 05/L-092 i cili është në fuqi që nga 1 shtatori 2015, kompanitë e sigurimit duhet të paguajnë 5 % tatim primi mbi primet e tyre tremujore bruto. Primet e kthyer dhe rregullimet e primit retrospektiv zbriten nga primet bruto për të arritur në bazën tatimore.

Tatimi mbi primet e shkruara bruto është paraqitur veçmas si një zbritje nga primet e shkruara bruto. Tatimi mbi primin përbën një pjesë të kostove të blerjes dhe shpenzohet kur ndodh. Sipas ligjit në Kosovë, kompanitë e sigurimeve nuk janë të detyruara të paguajnë tatimin mbi fitim

p. Vlerësimet e kontabël – Vlerësimi i pasigurisë në lidhje me rezervat teknike

Vlerësimet më të rëndësishme në pasqyrat financiare të Kompanisë lidhen me provizionet teknike. Kompania ka një qasje mjaft të kujdesshme sa i përket provizionimit. Menaxhmenti beson se niveli aktual i rezervave teknike është i mjaftueshëm.

4. ADAPTIMI I STANDARDEVE TË REJA OSE TË RISHIKUARA DHE INTERPRETIMET E TYRE

4.1 Standardet dhe interpretimet efektive për periudhën aktuale

Ndryshimet e standardeve ekzistuese dhe interpretimet në vijim të lëshuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit janë efektive për periudhën aktuale:

- **SNRF 9 "Instrumentet Financiare"** (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 Janarit 2018),
- **SNRF 15 "Të Ardhurat nga Kontratat me Konsumatorët"** dhe ndryshimet e mëtejshme (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2018)
- **Ndryshimet në SNRF 2 "Pagesa me aksione"** - Klasifikimi dhe matja e transaksioneve të pagesave të bazuara në aksione (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2018),
- **Ndryshimet në SNRF 4 "Kontratat e Sigurimeve"** - Zbatimi i SNRF 9 "Instrumentet Financiare" me SNRF 4 "Kontratat e Sigurimeve" (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2018 ose kur SNRF 9 "Instrumentet Financiare" zbatohet herën e parë)
- **Ndryshimet në SNK 40 "Prona e investuar"** - Transferet e Pronës së Investimit (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2018),
- **Ndryshimet në SNRF 1 dhe SNK 28 për shkak të "Përmirësimeve të SNRF-ve (cikli 2014-2016)"** që rezultojnë nga projekti vjetor i përmirësimit të SNRF-ve (SNRF 1, SNRF 12 dhe SNK 28) kryesisht me qëllim heqjen e mospërputhjeve dhe sqarimin e formulimit SNRF 1 dhe SNK 28 duhet të zbatohen për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2018),
- **KIRFN 22 "Transaksione në monedhë të huaj dhe Konsideratë paraprake"** (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2018).

Miratimi i këtyre ndryshimeve në standardet dhe interpretimet ekzistuese nuk ka sjellë ndonjë ndryshim material në pasqyrat financiare të Kompanisë.

4. ADAPTIMI I STANDARDEVE TË REJA OSE TË RISHIKUARA DHE INTERPRETIMET E TYRE (VAZHDIM)

4.2 Standardet dhe interpretimet që ende nuk janë efektive për periudhën aktuale

Standardet dhe interpretimet që janë lëshuar, por që nuk janë ende efektive, deri në datën e nxjerrjes së pasqyrave financiare të Kompanisë janë dhënë më poshtë. Kompania synon të miratojë këto standarde, nëse është e aplikueshme, kur të hyjnë në fuqi.

- **SNRF 16 "Qiratë"** (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2019),
- **SNRF 17 "Kontratat e Sigurimeve"** (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2021),
- **Ndryshimet në SNRF 3 "Kombinimet e Biznesit"** - Përcaktimi i një Biznesi (efektiv për kombinime biznesi për të cilat data e blerjes është në ose pas fillimit të periudhës së parë vjetore të raportimit që fillon më ose pas 1 janarit 2020 dhe për blerjet e aktiveve që ndodhin në ose pas fillimit të asaj periudhe)
- **Ndryshimet në SNRF 9 "Instrumentet Financiare"** - Karakteristikat e Parapagimit me Kompensim Negativ (efektiv për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 Janarit 2019),
- **Ndryshimet në SNRF 10 "Pasqyrat Financiare të Konsoliduara" dhe SNK 28 "Investimet në Shoqëritë dhe Sipërmarrjet e Përbashkëta"** - Shitja ose Kontributi i Aktiveve midis një Investitori dhe Bashkëpunëtorit të tij ose sipërmarrjes së përbashkët dhe ndryshimeve të mëtejshme (data efektive shtyhet për një kohë të pacaktuar deri në përfundimin e kërkimeve për metodën e kapitalit),
- **Ndryshimet në SNK 1 "Paraqitja e Pasqyrave Financiare" dhe SNK 8 "Politikat Kontabël, Ndryshimet në Vlerësimet Kontabël dhe Gabimet"** - Përkufizimi i Materialit (efektiv për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 Janarit 2020)
- **Ndryshimet në SNK 19 "Përfitimet e Punonjësve"** - Ndryshimi i Planit, Reduktimi ose Zgjidhja (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2019),
- **Ndryshimet në SNK 28 "Investimet në Shoqëritë dhe Sipërmarrjet e Përbashkëta"** - Interesat Afatgjatë në Shoqëritë dhe Sipërmarrjet e Përbashkëta (efektive për periudhat vjetore që fillojnë në ose pas 1 janar 2019),
- **Ndryshimet në standarde të ndryshme për shkak të "Përmirësimeve të SNRF-ve (cikli 2015-2017)"** që rezultojnë nga projekti vjetor i përmirësimit të SNRF-ve (SNRF 3, SNRF 11, SNK 12 dhe SNK 23) kryesisht me qëllim heqjen e mospërputhjeve dhe sqarimin e formulimit efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2019),
- **Ndryshimet në Referencat në Kornizën Konceptuale në Standardet e SNRF** (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 Janarit 2020),
- **KIRFN 23 "Pasiguria mbi Trajtimin e Taksave mbi të Ardhurat"** (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2019).

Kompania ka zgjedhur të mos i miratojë këto standarde, rishikime dhe interpretime përpara datave të tyre efektive. Kompania parashikon që miratimi i këtyre standardeve, rishikimeve dhe interpretimeve nuk do të ketë ndikim material në pasqyrat financiare të Kompanisë në periudhën e aplikimit fillestar.

5. MENAXHIMI I RISKUT TË SIGURIMIT

a. Objektivat e menaxhimit të riskut dhe politikat për zbutjen e riskut të sigurimit

Aktiviteti parësor i sigurimit i kryer nga Kompania merr përsipër riskun e humbjes nga personat ose organizatat që janë drejtpërdrejtë subjekt i riskut. Risqet e tilla mund të lidhen me jetën ose risqet tjera që mund të lindin nga një ngjarje e siguroshme. Si rezultat, Kompania është e ekspozuar ndaj pasigurisë që ka të bëjë me kohën dhe ashpërsinë e dëmeve sipas kontratës. Përmes veprimtarive të sigurimit dhe investimeve, ajo gjithashtu është e ekspozuar ndaj riskut të tregut.

Risku i sigurimit lidhet me pasigurinë në biznesin e sigurimeve. Përbërësit e rëndësishëm të riskut të sigurimit janë risku i primit dhe risku i rezervës. Këto risqe ndikojnë në adekuatshmërinë e normave të primit të sigurimit, provizioneve të detyrimeve të sigurimit dhe bazës së kapitalit.

Risku i primit është i pranishëm kur policat lëshohet përpara se ndonjë ngjarje e siguar të ketë ndodhur. Risku është që shpenzimi dhe humbja e shkaktuar do të jenë më të larta se primi i pranuar. Risku i rezervës paraqet riskun që niveli absolut i provizioneve teknike të vlerësohet gabimisht.

Përbërësit e riskut të biznesit të sigurimit të jetës përfshijnë riskun biometrik (që përfshinë vdekshmërinë dhe aftësinë e kufizuar) dhe riskun e përfundimit (lapse riks). Risku i përfundimit lidhet me norma të papritura të larta ose më të ulëta të përfundimit të policave, ndërprerjeve, ndryshimeve në statusin e paguar (ndërprerja e pagesave të primeve) dhe dorëzimit. Shkalla e vdekshmërisë dhe normat e garantuara të interesit kanë ndikimin më të madh në riskun që primi nuk do të jetë i mjaftueshëm për mbulimin e shpenzimeve dhe humbjeve të ndodhura

Normat e garantuara të interesit janë të kufizuara, ndërkohë që Kompania përdorë tabelat më të fundit të vdekshmërisë në dispozicion në Kosovë, të cilat janë prodhuar nga UNMIK-u në 2003 dhe përfshijnë statistika të ndara për popullsinë mashkullore dhe femërore.

Provizionet për sigurimin e jetës llogariten nga aktuari i Kompanisë për të gjitha policat aktive të sigurimit afatgjatë dhe ato të kapitalizuara, në përputhje me politikat e brendshme të Kompanisë dhe kërkesat e rregullatorëve. Provizionet llogariten duke përdorur metodën bruto Zillmer dhe llogariten ndaras për secilën policë. Në zbatimin e metodës bruto Zillmer për llogaritjen e provizioneve për sigurimin e jetës, Kompania përfshinë shpenzimet e marrjes në sigurim, përfshirë shpenzimet “alfa”, deri në 3.5% të shumës së siguar, që është brenda kufijve të përcaktuar nga rregullatori i sigurimeve. Shpenzimet e marrjes në sigurim nuk përfshihen në llogaritjen e provizioneve për sigurimin e jetës për policat e sigurimit në të cilat pala e siguar nuk është më e nevojshme për paguaj primet, siç janë sigurimet e kapitalizuara ose policat e sigurimit me një prim. Përdorimi i metodës bruto nuk ndikon në disbursimin e shumës së siguar. Supozimet e përdorura për llogaritjen e primeve janë të njëjtat me ato që përdoren për llogaritjen e provizioneve.

b. Strategjia e marrjes në sigurim

Kompania menaxhon riskun e sigurimit përmes limiteve të marrjes në sigurim, procedurave të aprovimit për transaksionet që përfshijnë produkte të reja ose që tejkalojnë limitet e caktuara, çmimoren, dizajnin e produktit dhe menaxhmin e risigurimit.

Strategjia e Kompanisë për marrjen në sigurim kërkon shumëllojshmëri për sigurimin e portfolios së balancuar dhe bazohet në një portfolio të madhe të risqeve të ngjashme për një kohë të gjatë, që redukton ndryshueshmërinë e rezultatit.

c. Strategjia e Risigurimit

Kompania risiguron një pjesë të riskut që merr në sigurim në mënyrë që të kontrollojë ekspozimin ndaj humbjeve dhe të mbrojë burimet e kapitalit. Kompania blen marrëveshje proporcionale të risigurimit që të reduktojë ekspozimin neto të riskut individual në më pak se 15,000 Euro për policat tradicionale të Miks - Jetës (policë ndihmëse) dhe policave të Bursës Studimore si dhe 10,000 Euro për policat e Sigurimit të Jetës në Grup.

5. MENAXHIMI I RISKUT TË SIGURIMIT (VAZHDIM)

c. Strategjia e Risigurimit (vazhdim)

Risigurimi i ceduar përmban riskun kreditor dhe një risigurimi i tillë i rikuperueshëm raportohet pas zbritjeve për njësi të njohura si të pa mbledhshme. Kompania monitoron kushtet financiare të të risiguarve në vazhdimësi dhe rishikon angazhimet e risigurimit në mënyrë periodike.

d. Terms and conditions of insurance contracts

Termet dhe kushtet e kontratave të sigurimit që kanë efekt material në shumën, kohën dhe pasigurinë e rrjedhës së parasë në të ardhmen që rrjedhin nga kontratat e sigurimit janë paraqitur më poshtë.

Produktet

Produktet e ofruara nga Kompania janë:

Miks-Jeta, e cila është një policë e zotërimit që paguan shumën e siguruar në kohën e vdekjes së të siguarit ose në datën e maturimit të policës, varësisht se cila ngjarje ndodh së pari;

Bursa Studimore, e cila është një policë e zotërimit që paguan një shumë fikse vjetore duke filluar nga data e maturimit të policës;

Shtesat në mbulesë të vdekjes, një benefit i vdekjes që paguhet në rast të vdekjes së personit të siguar. Nuk kontraktohet ndaras, por vetëm si shtesë e produktit të Bursës Studimore të shpjeguar më lartë.

Jeta në Grup, që jep mbulesë për vdekje vetëm përgjatë kohës së policës; dhe

Aksidentet Personale, (vdekje aksidentale, invaliditeti, shpenzimet mjekësore, ndihmesat ditore), benefitet të cilat paguhet në rastin e ndodhjes së ndonjë prej rasteve të lartpërmendura. Produktet e aksidenteve personale nuk shiten ndaras, por shiten si shtesa të policave kryesore.

Kompania nuk ofron produkte të lidhura në njësi.

Primet

Primet paguhet në këste të rregullta (muajore, kuartale, gjysëmvetore dhe vjetore), por gjithashtu edhe si shuma të plota. Primet pranohen në valutën Euro dhe Kompania nuk i ekspozohet riskut të valutës.

Indeksi është rritja e shumës të siguar përgjatë afatit të vlefshmërisë së sigurimit. Indeksi është opsional dhe mund të blihet për një prim shtesë. Për kontratat që përfshijnë opsionin e indeksimit, indeksi performohet çdo pesë vite, përpos nëse çmimi i shitjes së indeksit rritet në mënyrë kumulative për së paku 10%. Indeksi mund të performohet vetëm deri në pesë vite para përfundimit të kontratës së sigurimit. Nuk performohet indeksim gjatë pesë viteve të fundit të kontratës së sigurimit.

Ndarja e fitimit

Policë-mbajtësit e policave klasike të Miks-Jetës (policë ndihmëse) kanë të drejtë të marrin pjesë deri në 85% të fitimeve të gjeneruara nga Kompania gjatë menaxhimit të fondeve të sigurimit. Pjesa e mbetur 15% e fitimit të gjeneruar mbetet në Kompani.

Fitimi llogaritet në bazë të pasqyrave financiare të audituara për vitin paraprak. Fitimi llogaritet për çdo policë të sigurimit të jetës, e cila në përputhje me kushtet e përgjithshme ka të drejtë për pjesëmarrje në fitim. Fitimi për policat të cilat nuk marrin pjesë në ndarjen e fitimit, mbetet mbrenda Kompanisë. Fitimi i ndarë për mbajtësit e policave nuk paguhet, por përfshihet në shumën e siguar.

e. Përqendrimi i riskut të sigurimit

Një aspekt i riskut të sigurimit me të cilin ballafaqohet Kompania është shkalla e përqendrimit të riskut të sigurimit, i cili përcakton shkallën në të cilën një ngjarje ose seri e ngjarjeve të veçanta mund të ndikojnë ndjeshëm në detyrimet e Kompanisë. Përqendrimet e riskut mund të lindin në situata ku Kompania është e ekspozuar ndaj ndryshimeve të papritura në trende, për shembull, ndryshimet e papritura në vdekshmërinë njerëzore ose në sjelljen e policë-mbajtësve.

Risqet i marrjes në sigurim nga Kompania janë të vendosura në Republikën e Kosovës. Kompania është e ekspozuar ndaj riskut të përqendrimit nëpërmjet policave të saj të "Jeta në Grup". Menaxhmenti nuk konsideron që ekziston një përqendrim i rëndësishëm i riskut të sigurimit më 31 dhjetor 2018.

5. MENAXHIMI I RISKUT TË SIGURIMIT (VAZHDIM)

f. Ekspozimi në lidhje me ngjarjet katastrofike

Kompania konsideron se në aktivitetin e saj të sigurimit nuk ka akumuluar ekspozime lidhur me ngjarjet katastrofike.

6. MENAXHIMI I RISKUT FINANCIAR

Transaksionet në instrumentet financiare mund të rezultojnë në ndërmarrjen e më shumë risqeve financiare nga Kompania. Këto përfshijnë riskun e kredisë, riskun e tregut, riskun e monedhës dhe riskun e likuiditetit. Secili nga këto risqe financiare është përshkruar më poshtë.

Përcaktimi i vlerës së drejtë

Kompania matë vlerat e drejta duke përdorur hierarkinë e mëposhtme të vlerës së drejtë që pasqyron rëndësinë e inputeve të përdorura në bërjen e matjeve:

Niveli 1: Çmimi i kuotuar i tregut (i parregulluar) në një treg aktiv për një instrument identik;

Niveli 2: Teknikat e vlerësimit të bazuara në inputet e vëzhgueshme, ose të drejtpërdrejta (d.m.th., si çmime) ose indirekt (d.m.th., rrjedhin nga çmimet). Kjo kategori përfshinë instrumentet, nëse ka të tilla, të vlerësuar duke përdorur: çmimet e tregut të kuotuar në tregjet aktive për instrumente të ngjashme; çmimet e kuotuar për instrumente identike ose të ngjashme në tregjet që konsiderohen më pak se aktive; ose teknika të tjera vlerësimi ku të gjitha inputet e rëndësishme janë të vëzhgueshme në mënyrë direkte ose indirekte nga të dhënat e tregut;

Niveli 3: Teknikat e vlerësimit duke përdorur inpute të konsiderueshme jo të vëzhgueshme. Përveç kësaj, në këtë nivel përfshihen investimet në kompani bija, pjesëmarrje dhe aksione të tjera të kapitalit neto të deklaruar me kosto, të cilat nuk kanë vlerë të besueshme të tregut, nëse ka.

Më poshtë është paraqitur analiza e instrumenteve financiare të matura ose të dhëna në informacionet shpjeguese të vlerës së drejtë sipas metodave të vlerësimit të përdorura në vitin 2018 dhe 2017:

Më 31 dhjetor 2018:	Niveli 1:	Niveli 2:	Niveli 3:	Gjithsej
Ekivalentët e parasë	-	-	1,045,638	1,045,638
Depozitat e afatizuara	-	-	838,994	838,994
Letrat me vlerë të borxhit dhe letrat me vlerë të tjera me të hyra fikse	-	-	8,376,455	8,376,455
Gjithsej pasuritë financiare	-	-	10,261,087	10,261,087

Më 31 dhjetor 2017:	Niveli 1:	Niveli 2:	Niveli 3:	Gjithsej
Ekivalentët e parasë	-	-	563,837	563,837
Depozitat e afatizuara	-	-	3,733,673	3,733,673
Letrat me vlerë të borxhit dhe letrat me vlerë të tjera me të hyra fikse	-	-	6,064,471	6,064,471
Gjithsej pasuritë financiare	-	-	10,361,981	10,361,981

Risku kreditor

Në rrjedhën normale të biznesit, me pranimin e primeve, ato investohen për të paguar detyrimet e ardhshme për mbajtësit e policave. Kompania është e ekspozuar ndaj riskut kreditor në paranë e gatshme në bankë, letrat me vlerë të borxhit të mbajtur deri në maturim, depozitat me afat dhe palët e risigurimit. Kompania administron ekspozimin e saj ndaj riskut të kredisë në mënyrë të rregullt duke ndjekur me vëmendje ekspozimin ndaj letrave me vlerë të borxhit dhe të depozitave të afatizuara.

	2018	2017
Ekivalentët e parasë	1,045,638	563,837
Depozitat e afatizuara	838,994	3,733,673
Letrat me vlerë të borxhit dhe letrat me vlerë të tjera me të hyra fikse	8,376,455	6,064,471
Pasuri të tjera	142,448	1,787,764
Më 31 dhjetor	10,403,535	12,149,745

6. MENAXHIMI I RISKUT FINANCIAR (VAZHDIM)

Risku i tregut

Risku i tregut mund të përshkruhet si risku i ndryshimit në vlerën e drejtë të një instrumenti financiar për shkak të ndryshimeve në normat e interesit, çmimet e kapitalit ose normat e këmbimit valutor.

Risku i normave të interesit

Risku i normës së interesit përbëhet nga risku që vlera e një instrumenti financiar do të ndryshojë për shkak të ndryshimeve në normat e interesit të tregut dhe risku që maturitetet e pasurive që bartin interes ndryshojnë nga maturitetet e detyrimeve që bartin interes të përdorura për të financuar ato pasuri.

Kohëzgjatja për të cilën norma e interesit është e fiksuar në një instrument financiar tregon deri në çfarë mase është i ekspozuar ndaj riskut të normës së interesit. Pasuritë dhe detyrimet financiare të Kompanisë bartin norma interesi të tregut.

Risku që rrjedh nga ndryshimet në normat e interesit

Ekspozimi i kompanisë ndaj risqeve që rrjedhin nga ndryshimet në normat e interesit është relativisht i kufizuar. Kompania nuk është huamarrëse dhe investimet e saj janë kryesisht të përqendruara në instrumentet me normë fikse të interesit. Ekspozimi i Kompanisë ndaj risqeve nga ndryshimet në normat e interesit është më i madh kur merret parasysh rrjedha e ardhshme e parasë nga instrumentet me interes nëse kthimet nga këto investime bien nën normën e garantuar teknike të interesit për një periudhë të zgjatur kohore.

31 dhjetor 2018	Nuk bartin interes	Interes fiks deri në 1 vit	Interes fiks mbi një 1 vit	Gjithsej
Lloji i instrumentit financiar				
Ekuivalentët e parasë	1,045,638	-	-	1,045,638
Depozitat e afatizuara	-	838,994	-	838,994
Letrat me vlerë të borxhit dhe letrat me vlerë të tjera me të hyra fikse	-	269,361	8,107,094	8,376,455
Gjithsej	1,045,638	1,108,355	8,107,094	10,261,087

31 dhjetor 2017	Nuk bartin interes	Interes fiks deri në 1 vit	Interes fiks mbi një 1 vit	Gjithsej
Lloji i instrumentit financiar				
Ekuivalentët e parasë	563,837	-	-	563,837
Depozitat e afatizuara	-	3,307,437	426,236	3,733,673
Letrat me vlerë të borxhit dhe letrat me vlerë të tjera me të hyra fikse	-	1,994,043	4,070,428	6,064,471
Gjithsej	563,837	5,301,480	4,496,664	10,361,981

Risku i valutës

Kompania kryen transaksione kryesisht në Euro për të përmbushur kërkesat rregullatore dhe të vetëvendosura të kapitalit. Risku i valutës në portfolion e investimeve menaxhohet duke përdorur parimet e përputhjes së pasurive / detyrimeve.

Risku i likuiditetit

Risku i likuiditetit është relativisht i natyrshëm (inherent) në biznesin e Kompanisë, pasi pasuri të blera dhe detyrime të shitura të caktuara mund të kenë karakteristika të likuiditetit që janë specifike. Nëse Kompania kërkon shuma të rëndësishme me një njoftim të shkurtër, duke tejkuluar kërkesat normale të parasë, mund të hasë vështirësi për të marrë çmime atraktive. Kompania monitoron likuiditetin e saj në baza ditore në mënyrë që të menaxhojë detyrimet e saj kur ato duhet të paguhen.

ILLYRIA LIFE Sh.a
SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE
Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2018

(vlerat në Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

6. MENAXHIMI I RISKUT FINANCIAR (VAZHDIM)

Struktura e maturimit

Kompania duhet të plotësojë thirrjet potenciale të përditshme në burimet e saj të parasë, veçanërisht nga dëmet që rrjedhin nga kontratat e saj të sigurimit. Kjo shkakton riskun që paraja e gatshme të mos jetë e disponueshme për të shlyer detyrimet me një kosto të arsyeshme. Kompania menaxhon këtë risk duke vendosur kufizime minimale mbi përqindjen e maturimit të pasurive që do të jenë në dispozicion për të shlyer këto detyrime.

Struktura e maturimit të pasurive financiare të Kompanisë e paraqitur më poshtë bazohet në afatin e mbetur deri në maturim:

31 dhjetor 2018	Pa	Deri në 6	Prej 6 deri	Mbi 12	
Lloji i instrumentit financiar	maturim	muaj	12 muaj	muaj	Gjithsej
Ekuivalentët e parasë	320,175	725,463	-	-	1,045,638
Depozitat e afatizuara	-	838,994	-	-	838,994
Letrat me vlerë të borxhit dhe letrat me vlerë të tjera me të hyra fikse	-	-	269,361	8,107,094	8,376,455
Gjithsej	320,175	1,564,457	269,361	8,107,094	10,261,087

31 dhjetor 2017	Pa	Deri në 6	Prej 6 deri	Mbi 12	
Lloji i instrumentit financiar	maturim	muaj	12 muaj	muaj	Gjithsej
Ekuivalentët e parasë	300,198	263,639	-	-	563,837
Depozitat e afatizuara	600,000	252,010	2,455,428	426,236	3,733,673
Letrat me vlerë të borxhit dhe letrat me vlerë të tjera me të hyra fikse	3,027,572	1,994,043	-	1,042,856	6,064,471
Gjithsej	3,927,771	2,509,691	2,455,428	1,469,091	10,361,981

Zërat financiarë pa maturim janë zërat nën fondin e garancionit.

Testi i mjaftueshmërisë së rezervave dhe supozimeve aktuariale

Kompania llogaritë dhe ngarkon një rezervë të sigurimit të jetës (rezervë matematikore) për të siguruar pagesa të ardhshme në bazë të policave afatgjata të sigurimit. Shumë faktorë ndikojnë në llogaritjen e këtyre rezervave duke përfshirë vdekshmërinë, anulimet dhe interesin teknik. Rezerva e sigurimit të jetës llogaritet në bazë të supozimeve aktuale për parametrat bazë. Testi i mjaftueshmërisë së detyrimeve është i kufizuar në analizën e parametrave kryesorë që kanë ndikimin më të rëndësishëm në llogaritjen e rezervës.

"Vdekshmëria" është risku i mbuluar nga të gjitha produktet e sigurimeve, të marra në sigurim nga Kompania.

"Vdekshmëria" - të dhënat e ndodhjes së riskut për vitin 2017 duke përfshirë vlerësimet e përdorura janë si më poshtë:

Numri i personave të siguruar aktualisht, të ndjeshëm ndaj riskut të vdekjes	3,939 njerëz
Mosha mesatare e njerëzve të ndjeshëm ndaj riskut të vdekjes	43 vite
Numri i pagesave për vdekjet e të siguruarve në vitin 2017	1 rast
Numri i vlerësuar i vdekjeve për 1000 persona	3.48 raste
Numri aktual i vdekjeve për 1000 persona	0.25 raste

Prandaj, shfaqja aktuale e riskut të "Vdekshmërisë" e paraqitur në këtë tabelë është nën pritshmëri ndërsa vdekjet e raportuara kanë ndodhur dhe janë raportuar gjatë vitit 2018.

6. MENAXHIMI I RISKUT FINANCIAR (VAZHDIM)

Riblerja

Riblerjet mund të bëhen për produktin Miks-Jetë. Kur llogaritet primi merret parasysh probabiliteti i riblerjes. Probabiliteti i parashikuar për riblerje është më i larti në vitin e tretë me 5%, ndërkohë që niveli në vitin e njëzet është 1%.

Produkti i Kompanisë lejon riblerjet pas vitit të dytë, nëse maturimi i policës është më i shkurtër ose i barabartë me 15 vjet dhe pas vitit të tretë, nëse maturimi i policës është më i madh se 15 vjet. Në vitin 2018, 254 (2017: 262) persona të siguruar kanë riblerë policat e tyre, me vlerën përkatëse të riblerjes prej 400,876 Euro (2017: 367,992 Euro).

Interesi Teknik

Norma e interesit teknik prej 2.75% përdoret kur llogaritet rezerva. Norma e interesit teknik është kthimi minimal i garantuar për çdo kontratë të sigurimit të jetës. Ekziston risku që të hyrat nga investimet nuk mbulojnë kthimin minimal të garantuar. Në vitin 2018, të hyrat neto të gjeneruara nga investimet (përfshirë rezervat matematikore) mbulojnë të hyrat minimale të garantuara, duke dhënë fitim shtesë mbi interesin teknik.

Analiza e parametrave aktuarialë të përdorur në llogaritjen e tarifave dhe rezervave të sigurimit të jetës tregon se supozimet e bëra janë të besueshme dhe të kujdesshme. Zhvillimi i favorshëm i risqeve në krahasim me vlerat e pritura, garanton që rezervat janë të ngarkuara në mënyrë adekuate.

Risku i Risigurimit

Kompania cedon riskun e sigurimit për të kufizuar ekspozimin ndaj humbjeve të marrjes në sigurim sipas marrëveshjeve të veçanta për çdo lloj sigurimi. Këto marrëveshje risigurimi shpërndajnë riskun dhe minimizojnë efektin e humbjeve. Shuma e secilit risk të mbajtur varet nga vlerësimi i Kompanisë për riskun specifik, i cili në rrethana të caktuara i nënshtrohet kufizimeve maksimale në bazë të karakteristikave të mbulimit. Sipas kushteve të marrëveshjeve të risigurimit, risiguroesi pranon të rimburojë shumën e ceduar në rast se dëmi paguhet. Megjithatë, Kompania mbetet përgjegjëse ndaj siguroesve të saj në lidhje me sigurimin e ceduar nëse ndonjë risiguroes nuk arrinë të përmbushë detyrimet që merr.

Gjatë zgjedhjes së një risiguroesi Kompania konsideron sigurinë relative të tyre. Siguria e risiguroesit vlerësohet nga informacionet e klasifikimit publik dhe nga hetimet e brendshme. Aktualisht, risiguroesi ka një vlerësim të Standard and Poor's me BBB +, dhe një vlerësim të AM Best me A-.

Analiza e Ndjeshmërisë

Faktorët kryesorë që ndikojnë në fitimin e Kompanisë janë raporti i nivelit të dëmeve dhe shpenzimeve.

Simulimi më 31 dhjetor 2018	Fitimi / (Humbja)	Ekuiteti Neto	Fondi i garancionit të kërkuar
Aktual	315,669	4,676,733	3,200,000
Rritja e dëmeve me (+ 40%)	307,959	4,669,023	3,200,000
Shpenzimet rriten me (+ 10%)	273,543	4,634,607	3,200,000

Simulimi më 31 dhjetor 2017	Fitimi / (Humbja)	Ekuiteti Neto	Fondi i garancionit të kërkuar
Aktual	230,850	4,196,727	3,200,000
Rritja e dëmeve me (+ 40%)	182,602	4,148,479	3,200,000
Shpenzimet rriten me (+ 10%)	197,823	4,163,700	3,200,000

Tabela e mësipërme paraqet një simulim, duke marrë parasysh ndryshimet në dëmet e ndodhura ose rritjet në shpenzime dhe efektin e saj në kapitalin neto të Kompanisë dhe marzhën e aftësisë paguese në dispozicion.

6. MENAXHIMI I RISKUT FINANCIAR (VAZHDIM)

Risku Operacional

Risku operacional nënkupton riskun e humbjes që rezulton nga proceset jo adekuate ose proceset e dështuara të brendshme, njerëzit dhe sistemet, ose nga ngjarje të jashtme, dhe përfshinë riskun ligjor. Risku operacional mund të rrjedhë me një sistem informacioni joadekuat, gabime teknologjike, shkelje në kontrollin e brendshëm, mashtrime, rrethana të paparashikuara dhe probleme të tjera që kanë karakter operacional, gjë që rezulton me humbje të papritura.

Risqet operationale rrjedhin nga të gjitha operationet e Kompanisë. Qëllimi i Kompanisë është që të menaxhojë riskun operacional në një mënyrë për të arritur një balancë midis shmangies së humbjeve financiare dhe riskut të reputacionit dhe menaxhimit efektiv të kostove të Kompanisë.

Risqet të tjera

Ndryshimet në rregulloret qeverisëse në segmentet e biznesit në të cilat operon Kompania mund të ndikojnë në profitabilitet. Biznesi i sigurimeve është subjekt i mbikëqyrjes gjithëpërfshirëse dhe zhvillimore në Kosovë. Qëllimi kryesor i këtyre rregulloreve është mbrojtja e policë mbajtësve.

Ndryshimet në ligjet dhe rregulloret ekzistuese të sigurimeve mund të ndikojnë në mënyrën në të cilën Kompania kryen biznesin e saj dhe produktet e ofruara. Përveç kësaj, ligjet dhe rregulloret e sigurimit të miratuara dhe të ndryshuara herë pas here mund të jenë më kufizuese ose mund të rezultojnë me kosto më të larta se kërkesat aktuale.

Shpalosjet dhe vlerësimet e vlerave të drejta

Vlerësimet e vlerës së drejtë, nëse ka, janë të bazuara në instrumentet financiare ekzistuese pa bërë përpjekje për të vlerësuar vlerën e ardhshme të biznesit dhe vlerën e pasurive dhe detyrimeve që nuk konsiderohen si instrumente financiare.

7. SNK 7 Iniciativa për Shpalosje - Ndryshime në SNK 7

	1 janar 2018	Rrjedhat e parasë	Interesat akruar	Deklarimet e dividendës	31 dhjetor 2018
Huatë që bartin interes	3,005,927	(3,000,000)	(5,927)	-	-
Dividenda e paguar	-	(100,000)	-	100,000	-
Gjithsej detyrimet prej aktiviteteve financiare	3,005,927	(3,100,000)	(5,927)	100,000	-

8. PARAJA DHE EKVIVALENTËT E PARASË

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Paraja në arkë	44	213
Paraja në bankë	1,045,638	563,837
Gjithsej	1,045,682	564,050

Ekuivalentët e parasë në Bankë përfshijnë llogaritë rrjedhëse në shumën prej 1,045,638 mijë Euro (2017: 563,837 Euro) në Raiffeisen Bank, ProCredit Bank, TEB, NLB Prishtina, Banka për Biznes, Banka Kombëtare Tregtare, Banka Qendrore e Kosovës, Banka Ekonomike, Ziraat Bank dhe IS Bank.

ILLYRIA LIFE Sh.a
SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE
Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2018
 (vlerat në Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

9. DEPOZITAT E AFATIZUARA, LETRAT ME VLERË TË BORXHIT DHE TË TJERA ME TË HYRA FIKSE

Ndarja e depozitave me afat me maturitet mbi tre muaj është si më poshtë:

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
ISBANK	-	1,200,000
Banka Kombëtare Tregtare	-	1,100,000
NLB Prishtina	-	600,000
Ziraat Bank	420,000	420,000
Banka per Biznes	400,000	350,000
Interesi i përllogaritur	18,994	63,673
Gjithsej	838,994	3,733,673

Sipas udhëzimit administrativ nr. 01/2009 të miratuar nga Banka Qendrore e Kosovës, kompanitë e sigurimit të jetës lejohen të investojnë para nga fondi i kapitalit pas miratimit të planit të investimeve nga BQK-ja, i cili është dhënë më 8 prill 2009. Normat e interesit vjetor të depozitave të afatizuara gjatë 2018 variojnë nga 1.30% në 4.00% (2017: 1.30% deri 4.00%).

Të ardhurat bruto nga interesi prej 74,015 Euro (2017: 95,186 Euro) janë fituar nga depozitat e afatizuara. Tatimi në burim prej 10% (2017: 10%) është zbatuar në të ardhurat nga interesi dhe ndalet nga bankat kur paguhet interesi për Kompaninë.

Më 31 dhjetor 2018, Kompania ka një pjesë të pasurive të saj në letrat me vlerë të borxhit sovran, të mbajtur nën kujdestari në NLB Prishtina, si më poshtë

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Obligacionet e Qeverisë së Kosovës – në dispozicion për shitje	8,376,455	6,064,471
Gjithsej	8,376,455	6,064,471

Letrat me vlerë të borxhit sovran të klasifikuara si në dispozicion për shitje kanë një kthim në maturitet prej 1.4% deri 5.20%.

Letrat me vlerë të borxhit sovran janë përcaktuar si të menaxhuara në bazë të vlerës së drejtë; Niveli 3 (shihni Shënimin 6) i rezervës së rivlerësuar ka një gjendje prej 274,837 euro (2017: 416,356 Euro).

Të ardhurat nga interesi prej 242,175 Euro (2017: 102,613 Euro) janë fituar nga letrat me vlerë të borxhit sovran.

10. PJESA E RISIGURUESVE PËR DETYRIMET E SIGURUARA

Në fund të vitit, pjesa e risiguruesve për detyrimet e sigurimit është si më poshtë:

	31 dhjetor 2018	Ndryshimi për periudhën	31 dhjetor 2017
Pjesa e risiguruesve për detyrimin e sigurimit të primit të pa fituar			
Kapitali i jetës	14,333	(2,708)	11,625
Shtesat	10,988	(4,220)	6,768
	25,321	(6,928)	18,393
Pjesa e risiguresve për detyrimin e sigurimit të rezervave të dëmeve	-	-	-
Gjithsej	25,321	(6,928)	18,393

ILLYRIA LIFE Sh.a
SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE
Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2018
(vlerat në Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

11. PRONA, IMPIANTET DHE PAJISJET

	Ndërtesat dhe lokalet	Pajisjet kompjuterike	Mobilje të zyrës dhe të tjera	Pajisje të tjera	Softuerët	Gjithsej
Kostoja						
Gjendja më 1 janar 2017	589,062	10,678	15,132	660	95,491	711,003
Shtesat	-	-	-	-	5,617	5,617
Gjendja më 31 dhjetor 2017	589,042	10,678	15,132	660	101,108	716,620
Gjendja më 1 janar 2018						
Gjendja më 1 janar 2018	589,042	10,678	15,132	660	101,108	716,620
Shtesat	-	4,522	919	-	-	5,441
Gjendja më 31 dhjetor 2018	589,042	15,199	16,051	660	101,108	722,061
Zhvlerësimi dhe amortizimi i akumuluar						
Gjendja më 1 janar 2017	(62,183)	(10,493)	(10,128)	(660)	(84,218)	(167,682)
Shpenzimi për vitin	(7,657)	(164)	(1,513)	-	(8,357)	(17,691)
Gjendja më 31 dhjetor 2017	(69,840)	(10,657)	(11,641)	(660)	(92,575)	(185,373)
Gjendja më 1 janar 2018						
Gjendja më 1 janar 2018	(69,840)	(10,657)	(11,641)	(660)	(92,575)	(185,373)
Shpenzimi për vitin	(7,657)	(630)	(1,027)	-	(4,882)	(14,197)
Gjendja më 31 dhjetor 2018	(77,497)	(11,287)	(12,668)	(660)	(97,457)	(199,570)
Vlera kontabël						
Gjendja më 31 dhjetor 2017	519,202	21	3,491	-	8,533	531,247
Gjendja më 31 dhjetor 2018	511,545	3,913	3,383	-	3,651	522,491

ILLYRIA LIFE Sh.a
SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE
Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2018
(vlerat në Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

12. PASURI TË TJERA

Pasuritë e tjera përbëhen nga:

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Depozitat e afatizuara	-	888,839
Të arkëtueshmet lidhur me transferimin e portfolios nga Grawe	-	726,437
Primet e arkëtueshme	118,028	113,401
Pasuri të tjera	11,005	18,705
Të arkëtueshmet nga Sava Re	9,644	35,928
Të arkëtueshmet nga punonjësit	410	2,521
Kostoja e shtyrë e marrjes në sigurim	3,361	1,933
Gjithsej	142,448	1,787,764

Depozitat e afatizuara përbëhen nga një depozitë në Banka Ekonomike 600,000 Euro, një tjetër në NLB Banka sh.a. 260,000 Euro dhe interesi përkatës i përlllogaritur 28,839 Euro. Këto depozita maturuan më 31 dhe 30 dhjetor 2017 respektivisht. Megjithatë, transferimi në llogari ka ndodhur më 3 dhe 4 janar 2018, respektivisht. Prandaj, zërat e tillë janë klasifikuar si të arkëtueshme të tjera.

Më 13 tetor 2017, GRAWE Kosova, J.S.C. nënshkroi një marrëveshje për transferim në ILLYRIA Life J.S.C të portfolios së Sigurimit të Jetës dhe data e transferimit të vendosur ishte 31 dhjetor 2017. Banka Qendrore e Kosovës si organ mbikëqyrës, ka miratuar transferimin më 4 dhjetor 2017.

Portfolio e transferuar përbëhet nga 385 polica dhe disa prej tyre përmbajnë shtesa opsionale të përfshira në formën e aksidenteve personale.

Provizionet Teknike në shumën prej 530,807 Euro që janë transferuar në Kompani përfshijnë 430,962 Euro provizore matematikore, 79,845 Euro UPR dhe 20,000 Euro IBNR. Më tej, Kompania ka ngarkuar GRAWE Kosova, J.S.C. për transferimin e portfolios në shumën prej 150,000 Euro pa TVSH. Çmimi i transferimit të portfolios u njoh në të ardhurat e tjera në vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017.

Siguruesi i transferit (GRAWE) më 15 janar 2018 ka bërë një transferim bankar në llogarinë e Illyria Life për të gjithë shumën e provizioneve teknike që i përkasin një portfolios të tillë. Transferi bankar gjithashtu përfshinte edhe tarifën e transferimit prej 177,000 Euro përfshirë TVSH-në.

Një tjetër zë i përfshirë në "Të arkëtueshme nga Grawe në lidhje me transferimin e portfolios" janë parapagimet e bëra nga konsumatorët e Grawes për Grawe-n në shumën prej 18,000 Euro në lidhje me policat e tyre. Kjo shumë u kërkuar nga Grawe dhe me pajtimin e tyre u njoh si e arkëtueshme kundrejt të hyrave të shtyra në fundvit. Shuma është arkëtuar nga Grawe menjëherë pas fundit të vitit.

Primet e arkëtueshme bruto në fund të vitit 2018 janë 186,537 Euro (2017: 160,794 Euro). Në përputhje me politikën e Kompanisë, kjo shumë ka pësuar rënie në vlerë me një vlerë të barabartë me 68,509 Euro (2017: 47,393 Euro).

Të arkëtueshmet nga Sava në shumën 9,644 euro (2017: 35,928 Euro) përfaqësojnë të arkëtueshme për pjesën e risiguruesit në dëmet e paguara prej 8,176 euro (2017: 30,114 Euro) dhe shumat e arkëtueshme për komisionin e risigurimit prej 1,469 Euro (2017: 5,814 Euro).

Kostoja e shtyrë e marrjes në sigurim ("DAC") është krijuar vetëm për produktet e shtesave. DAC është llogaritur në përputhje me rezervën e primit të pa fituar duke përdorur metodën e përkohshme proporcionale (pro-rata temporis), për komisionet e agjentëve, tarifat e BQK-së dhe tatimet mbi primet.

ILLYRIA LIFE Sh.a
SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE
Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2018
 (vlerat në Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

13. DETYRIMET E SIGURIMIT PËR HUMBJET DHE SHPENZIMET E RREGULLIMIT TË HUMBjes

	2018	2017
Detyrimet e sigurimit për humbjet dhe shpenzimet e rregullimit të humbjes më 1 janar	5,012,095	3,914,781
Humbjet dhe shpenzimet e rregullimit të humbjes, të shkaktuara	1,185,466	1,188,893
Rezervat në lidhje me transferin e portfolios nga GRAWE	58,579	450,962
Humbjet dhe shpenzimet e rregullimit të humbjes, të paguara	(450,046)	(542,541)
Detyrimet e sigurimit për humbjet dhe shpenzimet e rregullimit të humbjes më 31 dhjetor	5,806,094	5,012,095

Detyrimet e sigurimit për humbjet dhe shpenzimet e rregullimit të humbjes përbëhen nga:

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Provizioni për sigurimin e jetës	5,772,481	4,882,784
Rezervat e IBNR	33,613	129,311
Rezervat e RBNS	-	-
Gjithsej	5,806,094	5,012,095

Provizioni i sigurimit të jetës regjistrohet në bazë të policës duke përdorur faktorë të llogaritjes standarde të bazuara në formulimet aktuariale, supozimet e çmimeve mbi vdekshmërinë dhe normat e interesit të përdorura.

Një masë e konsiderueshme e përvojës dhe gjykimit është e përfshirë në vlerësimin e detyrimeve të paguara të sigurimit; kostot përfundimtare nuk mund të vlerësohen me siguri në datën e raportimit. Detyrimet e sigurimit për humbjet dhe shpenzimet e rregullimit të humbjes përcaktohen në bazë të informacionit që është aktualisht në dispozicion; megjithatë, është e natyrshme në natyrën e biznesit që detyrimet përfundimtare të mund të ndryshojnë si rezultat i zhvillimeve të mëvonshme.

14. DETYRIMET E SIGURIMIT PËR PRIMET E PA FITUARA

Detyrimet e sigurimit për primet e pa fituara sipas produktit përbëhen si më poshtë:

Produkti	31 dhjetor 2018	Blerja e portfolios së Grawe	Ndryshimi për periudhën	31 dhjetor 2017
<i>Kapitali i jetës:</i>				
Sigurimi Miks-Jetë	207,953	-	(635)	208,588
Bursa studimore	1,419	-	(4)	1,423
Sigurimi i jetës në grup	-	-	-	-
<i>Shtesat:</i>				
Vdekja në aksident	6,203	-	(19)	6,222
Pa-aftësia nga aksidenti	3,886	-	(12)	3,898
Kompensimi ditor	29	-	(0)	29
Shpenzimet mjekësore	1,337	-	(4)	1,341
Shtesat në sigurimin afatgjatë të jetës	67	-	(0)	67
Gjithsej	220,894	-	(674)	221,568

ILLYRIA LIFE Sh.a
SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE
Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2018
 (vlerat në Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

14. DETYRIMET E SIGURIMIT PËR PRIMET E PA FITUARA (VAZHDIM)

Produkti	31 dhjetor 2017	Blerja e portfolios së Grawe	Ndryshimi për periudhën	31 dhjetor 2016
<i>Kapitali i jetës:</i>				
Sigurimi Miks-Jetë	208,588	77,408	5,324	125,856
Bursa studimore	1,423	-	832	591
Sigurimi i jetës në grup	-	-	-	-
<i>Shtesat:</i>				
Vdekja në aksident	6,222	2,437	35	3,750
Pa-aftësia nga aksidenti	3,898	-	(148)	4,046
Kompensimi ditor	29	-	-	29
Shpenzimet mjekësore	1,341	-	5	1,336
Shtesat ne sigurimin afatgjatë të jetës	67	-	67	-
Gjithsej	221,568	79,845	6,115	135,608

15. TË ARDHURAT E SHTYRA

	31 dhjetor 2018	Ndryshimi për periudhën	31 dhjetor 2017
Primet e marra në avans	12,200	(38,944)	51,144
Komisioni i pa fituar për risigurimin	4,371	1,469	2,902
Gjithsej	16,571	(37,475)	54,046

Primet e grumbulluara ne anvas përfaqësojnë pagesat e klientëve data e pagesës të të cilave është pas 31 dhjetorit 2018. Komisioni i risigurimit të pa fituar ka të bëjë me komisionet për primet e pa fituara në datën e raportimit.

16. DETYRIME TË TJERA

Detyrimet e tjera përbëhen nga:

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Detyrimet ndaj brokerëve (“WVP dhe L.I.F.E. Kosova”)	844	2,880
Detyrimet ndaj autoriteteve tatimore (shih më poshtë)	32,844	76,621
Detyrimet ndaj punonjësve dhe kontributet pensionale	27,622	37,652
Detyrimet ndaj SAVA RE	55,264	35,822
Detyrimet ndaj BQK	7,464	5,916
Të pagueshmet tjera	96,562	50,344
Gjithsej	220,600	209,235

ILLYRIA LIFE Sh.a
SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE
Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2018

(vlerat në Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

16. DETYRIME TË TJERA (VAZHDIM)

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Tatimi i pagueshëm mbi primin	27,664	21,910
TVSH e pagueshme	236	27,234
Tatime tjera të pagueshme	-	16,451
Tatimi i pagueshëm mbi të hyrat nga interesi	1,925	9,277
Tatimi i pagueshëm mbi të ardhurat personale	3,019	1,749
Gjithsej	32,844	76,621

Të pagueshmet e tjera lidhen me shpenzimet e caktuara administrative dhe pagesat e bëra të cilat më 31 dhjetor 2018, janë njohur, por ende nuk janë paguar.

17. HUATË

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Detyrimi ndaj SAVA RE	-	3,000,000
Interesi i përllogaritur	-	5,927
Gjithsej	-	3,005,927

Detyrimi ndaj SAVA RE përbëhet nga tri marrëveshje huazimi:

- Kredia e disbursuar më 28 gusht 2017 në vlerë prej 1,000, mijë Euro e cila ka maturuar më 12 korrik 2018 dhe ka bartur normën e interesit 3 muaj Euribor + 0.9%;
- Kredia e disbursuar më 28 gusht 2017 në vlerë prej 350 mijë Euro e cila ka maturuar më 31 maj 2018 dhe ka bartur normën e interesit 1.5%;
- Kredia e disbursuar më 29 nëntor 2017 në vlerë prej 1,650 mijë Euro e cila ka maturuar më 30 qershor 2018 dhe ka bartur normën e interesit 1.5%;

18. KAPITALI AKSIONAR

Kapitali aksionar i autorizuar, i emetuar dhe plotësisht i paguar i Kompanisë është 3,285,000 Euro, i përbërë nga 6,570 aksione të zakonshme me vlerë nominale prej 500 Euro, të gjitha të paguara deri më datën e raportimit. Kapitali aksionar përbëhet nga:

Aksionari	Numri i aksioneve	Vlera nominale për aksion	Kapitali i paguar për aksion	Shuma nominale (Euro)	Shuma e paguar (Euro)	Përqindja
Sava RE	6,570	500	500	3,285,000	3,285,893	100.00%
Gjithsej	6,570	500	500	3,285,000	3,285,893	100.00%

Shuma e kapitalit të regjistruar dhe paguar deri më 31 dhjetor 2018 është 3,285,893 Euro.

ILLYRIA LIFE Sh.a
SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE
Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2018

(vlerat në Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

19. PRIMET E SHKRUARA BRUTO DHE TATIMI MBI PRIMET

Primet e shkruara bruto (GWP) dhe tatimi mbi prime sipas produktit në fund të vitit përbëhen si më poshtë:

Produkti	31 dhjetor 2018		31 dhjetor 2017	
	Primi i shkruar bruto	Tatimi mbi prim	Primi i shkruar bruto	Tatimi mbi prim
<i>Kapitali i jetës:</i>				
Sigurimi Miks-Jetë	1,914,619	95,731	1,560,289	78,015
Bursa studimore	39,430	1,972	35,859	1,793
Sigurimi i jetës në grup	9,420	471	6,087	304
<i>Shtesat:</i>				
Vdekja në aksident	59,837	2,992	43,460	2,173
Pa-aftësia nga aksidenti	48,120	2,406	40,449	2,022
Kompensimi ditor	152	8	152	8
Shpenzimet mjekësore	24,416	1,221	21,404	1,070
Shtesat ne sigurimin afatgjatë të jetës	727	36	666	33
Gjithsej	2,096,721	104,836	1,708,366	85,418

Norma e tatimit mbi primet është 5% (2017: 5% p.a.).

20. PRIMET E CEDUARA TE RISIGURUESI

Primet sipas produkteve të ceduara tek risiguruesi në fund të vitit përbëhen si në vijim:

Produkti	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
<i>Kapitali i jetës:</i>		
Sigurimi Miks-Jetë	30,819	21,923
Bursa studimore	29,565	21,923
Sigurimi i jetës në grup	-	-
Sigurimi i jetës në grup	1,254	-
<i>Shtesat:</i>		
Vdekja në aksident	24,445	13,899
Pa-aftësia nga aksidenti	15,645	7,162
Shtesat ne sigurimin afatgjatë të jetës	8,800	6,737
Shtesat ne sigurimin afatgjatë të jetës	-	-
Gjithsej	55,264	35,822

ILLYRIA LIFE Sh.a
SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE
Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2018
 (vlerat në Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

21. KOMISIONI I RISIGURIMIT

Komisioni i risigurimit sipas produktit në fund të vitit përbëhet si në vijim:

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
<i>Kapitali i jetës:</i>		
Sigurimi Miks-Jetë	2,218	1,645
Bursa studimore	-	-
Sigurimi i jetës në grup	94	-
<i>Shtesat:</i>		
Vdekja në aksident	4,693	2,148
Pa-aftësia nga aksidenti	2,640	2,021
Shtesat ne sigurimin afatgjatë të jetës	-	-
Gjithsej komisioni i risigurimit i llogaritur	9,645	5,814
Pjesa e pa fituar e komisionit të risigurimit (shënimi 15)	(1,469)	(153)
Gjithsej komisioni i risigurimit	8,176	5,661

22. KOSTOJA E MARRJES NË SIGURIM

Kostoja e marrjes në sigurim përbëhet si më poshtë:

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Komisioni i agentit, duke përfshirë shpenzimet tatimore dhe kontributet pensionale	221,098	174,755
Komisioni i brokerëve	23,104	32,112
Tarifat e BQK-së	28,306	23,063
Kostot e shtyra të marrjes në sigurim	(1,428)	23
Gjithsej	271,080	229,953

Kompania shfrytëzon brokerët "WVP - Broker për sigurim LLC" dhe "L.I.F.E. Kosova L.L.C." për të shitur policat e sigurimit në emër të kompanisë.

23. TË ARDHURAT E TJERA

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Tarifa e transferit	-	150,000
Të arkëtueshmet nga portfolio e transferuar	-	17,888
Gjithsej	-	167,888

Kompania ka ngarkuar GRAWE Kosova, J.S.C. për transferimin e portfolios në shumën prej 150,000 Euro pa TVSH. Çmimi i transferimit të portfolios u njoh në ardhurat e tjera në vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017. Përveç kësaj, Grawe kishte 17,888 Euro të arkëtueshme nga klientët e saj në datën e transferimit. Zërat e tillë njihen si të arkëtueshme nga klientët kundrejt të hyrave të tjera.

Tatimi në të ardhura mbi tarifën e transferimit është në shumën prej 16,451 Euro (shënimet 23,15)

ILLYRIA LIFE Sh.a
SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE
Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2018
 (vlerat në Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

24. SHPENZIMET ADMINISTRATIV

Shpenzimet administrative në fund të vitit përbëhen si në vijm:

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Pagat dhe shpenzimet e lidhura (shënimi 25)	234,643	177,897
Tarifat për shërbime profesionale	43,007	27,866
Mirëmbajtja e sistemit bazë	18,903	32,595
Shpenzimet e zhvlerësimit dhe amortizimit	14,199	2,698
Shpenzimet e udhëtimit dhe akomodimit	7,886	20,785
Furnizimet e zyrës	8,721	16,451
Shpenzimet e telefonit dhe postës	5,979	9,447
Shpenzimet e reprezentacionit	6,584	17,691
Rënia në vlerë e të arkëtueshmeve	21,117	4,842
Taksat tjera	-	5,014
Shpenzimet të tjera	49,724	1,869
Gjithsej	410,761	317,154

25. PAGAT DHE SHPENZIMET E LIDHURA

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Pagat neto	169,017	121,882
Tatimi në të ardhura	19,968	10,249
Kontributet pensionale	10,840	14,532
Sigurimi shëndetësor	9,375	5,975
Shpenzimet e përlogaritura të bonuseve	25,443	25,259
Gjithsej	234,643	177,897

26. ZOTIMET DHE KONTIGJENCAT

i. Ligjore

Kompania është e përfshirë në procedurat rutinore ligjore në rrjedhën normale të biznesit. Nuk ka asnjë padi të rëndësishme të pazgjidhura më 31 dhjetor 2018.

Kompania nuk ka ndonjë zotim ose kontigjencë shtesë të njohur më 31 dhjetor 2018.

27. TRANSAKSIONET ME PALËT E LIDHURA

Kompania ka marrëdhënie të lidhura me aksionarët, me kompaninë motër, me bordin e drejtorëve dhe me menaxhmentin. Në vijim janë palët e lidhura të Kompanisë dhe marrëdhëniet përkatëse:

- Sava RE. – Kompania mëmë (100%);
- Illyria sh.a. – Kompani bijë e Sava Re;
- Primoz Mocivnik, Kryetar i Bordit të Drejtorëve (BoD);
- Milan Versek, anëtar i Bordit të Drejtorëve (BoD);
- Rok Moljk, anëtar i Bordit të Drejtorëve (BoD);
- Gianni Sokolic, anëtar i Bordit të Drejtorëve (BoD);;
- Robert Sraka, anëtar i Bordit të Drejtorëve (BoD);;
- Albin Podvorica, anëtar i Bordit të Drejtorëve (BoD) dhe drejtori gjeneral i Kompanisë.

27. TRANSAKSIONET ME PALËT E LIDHURA (VAZHDIM)

Transaksionet me palët e lidhura

Një përmbledhje e transaksioneve të palëve të lidhura, të kryera në bazë të parimit “arm’s length”, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2018 dhe 2017 është paraqitur më poshtë:

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Kompensimet e menaxhmentit kyç	59,125	97,348
Detyrimet ndaj Sava RE	55,264	35,822
Të arkëtueshmet nga Sava RE	9,644	35,928
Detyrimet ndaj Illyria Sh.a.	2,305	5,789

Transaksionet me kompaninë mëmë

Kompania nënshkroi një kontratë risigurimi me Sava Re më 19 nëntor 2008, e cila është gjithashtu aksionari i Kompanisë me 100%.

Gjatë vitit 2018, Kompania ka ceduar 55,264 Euro (2017 35,822 Euro) te Sava Re në lidhje me primet e shkruara bruto të kontraktuara gjatë vitit 2018. E tërë shuma mbetet e papaguar ndaj SAVA RE më 31 dhjetor 2018. Shih shënimin 19 për detajet e primeve të ceduara te SAVA RE nga produktet e sigurimit të jetës.

Transaksionet me Illyria Sh.a. – kompaninë motër dhe kompaninë bijë të Sava Re

Kompania ka kontraktuar shërbime profesionale të përbëra nga teknologjia informative, ligjore, mirëmbajtja e zyrave, sigurim shëndetësor dhe auditimi i brendshëm nga kompania motër Illyria sh.a. që arrijnë në shumën prej 31,797 Euro për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2018 (2017: 23,155 Euro).

28. NGJARJET PAS DATËS RAPORTUESE

Nuk ka ngjarje të rëndësishme pas datës së raportimit që do të kërkonin rregullime ose shpalosje shtesë në pasqyrat financiare të Kompanisë.

Shënimet plotësuese

Tabela 1: Llogaritja e Solvencës

Përshkrimi	2018	2017
Margjina e solvencës në dispozicion (Tabela 2)	4,673,082	4,188,194
Fondi Garantues	3,200,000	3,200,000
I. Produktet e Sigurimit të Përshkruara në Seksionin 12 (2)		
Rezultati i parë	230,899	195,311
Rezultati i dytë	106,336	90,367
Margjina e kërkuar e solvencës	337,235	285,679
II. Produktet e Sigurimit të Përshkruara në Seksionin 12 (3)		
Rezultati i primit	22,651	19,004
Rezultati i dëmit	13,625	15,855
Margjina e kërkuar e solvencës	22,651	19,004
Gjithsej margjina e kërkuar e solvencës	359,886	304,682
Teprica/mungesa e solvencës	4,313,196	3,883,512
Fondi Garantues	3,200,000	3,200,000

Tabela 2: Margjina e Solvencës në Dispozicion

Përshkrimi	2018	2017
Seksioni 11.2		
Kapitali aksionar i paguar	3,285,893	3,285,893
Aksionet e Thesarit (-)		
Rezervat	691,193	416,356
<i>Rivlerësimi i Rezervave</i>	691,193	416,356
<i>Rezervat për pasuritë e tatimit të shtyrë</i>	-	0
<i>Rezervat të tjera</i>	-	0
Fitimet e mbajtura	394,479	230,850
Fitimi neto pas zbritjes së dividendës së pagueshme:	315,669	(100,000)
Gjithsej Seksioni 11.2	4,687,234	3,833,099
Seksioni 11.3		
Kapitali aksionar i preferuar dhe kapitali i kredive të varura:	-	-
<i>Kapitali aksionar i preferuar me maturim fiks</i>	-	-
<i>Kapitali aksionar i preferuar pa maturim fiks</i>	-	-
<i>Kapitali i kredive të varura me maturim fiks</i>	-	-
<i>Kapitali i kredive të varura pa maturim fiks</i>	-	-
Letrat me vlerë pa datë specifike të maturimit dhe instrumentet tjera	-	-
Gjithsej Seksioni 11.3	-	-
Zbritjet		
Pasuritë e paprekshme	3,651	8,533
Gjithsej Zbritjet	3,651	8,533
Margjina e Solvencës në Dispozicion	4,687,234	3,824,566
Fondi Garantues	3,200,000	3,200,000

Tabela 3: Margjina e kërkuar e Solvencës

Përshkrimi	2018	2017
I. Produktet e Sigurimeve të Përshkruara në Seksionin 12 (2)		
Provizionet matematikore bruto	5,772,482	4,882,784
Provizionet matematikore bruto (Risigurimi i ceduar)	-	-
Rezultati i parë	230,899	195,311
Kapitali në risk		
Sigurimi i përkohshëm i vdekjes me kohëzgjatje: < 3 vite	2,320,000	1,620,000
Sigurimi i përkohshëm i vdekjes me kohëzgjatje: 3 – 5 vite	74,422	23,526
Të gjitha të tjerat përveq sigurimit të përkohshëm të vdekjes me kohëzgjatje < 5 vite	41,442,367	35,829,849
Kapitali në risk (Risigurimi i rikuperueshëm)		
Sigurimi i përkohshëm i vdekjes me kohëzgjatje: < 3 vite	835,200	-
Sigurimi i përkohshëm i vdekjes me kohëzgjatje: 3 – 5 vite	11,163	-
Të gjitha të tjerat përveq sigurimit të përkohshëm të vdekjes me kohëzgjatje < 5 vite	6,216,355	6,446,983
Rezultati i dytë	106,336	90,367
II. Produktet e Sigurimit të Përshkruara në Seksionin 12 (3)		
Dëmet e ndodhura		
<i>Viti aktual N</i>	14,284	109,311
<i>Viti aktual N-1</i>	209,311	37,986
<i>Viti aktual N-2</i>	33,613	35,651
Risigurimi i rikuperueshëm		
<i>Viti aktual N</i>	-	-
<i>Viti aktual N-1</i>	-	-
<i>Viti aktual N-2</i>	-	-
Raporti i mbajtjes	100%	100%
Bazat e primit		
Primi i shkruar bruto	132,525	105,465
(Ndryshimi) Rezervat për primin e pafitur	(6,689)	110
Tatimet dhe taksat	-	-
Gjithsej baza e primit	125,837	105,575
Rezultati i primit	22,651	19,004
Rezultati i dëmeve	22,291	15,855

ILLYRIA LIFE Sh.a
Shënime të Plotësues
Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2018
(vlerat në Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

Tabela 4: Pasuritë që mbulojnë provizionet teknike

Përshkrimi	Shuma e investuar	% e Lejuar	Shuma e lejuar
Depozitat bankare , me maturitet mbi 3 muaj	838,994	Pa limituara	838,994
Letrat me vlerë - shtetërore	5,176,455		5,176,455
Qeveria e Kosovës	5,176,455	Pa limituara	5,176,455
Bonot e thesarit	0		0
Obligacionet	5,176,455		5,176,455
Të tjera	-		-
Vendet e BE-së , me vlerësim >= BBB	-	20% gjithsej, 5% prej çdo investimi	-
Bonot e thesarit	-		-
Obligacionet	-		-
Të tjera	-		-
Toka dhe ndërtesat	-	20% gjithsej, 10% prej çdo investimi	-
Prona për përdorim vetanak	-		-
Prona për qëllime investimi	-		-
Paraja dhe ekuivalentët e parasë	725,508	3%	180,810
Depozitat me maturitet <= 3 muaj	-		-
Llogaritë rrjedhëse	725,463		725,463
Paraja në arkë	44		44
Të arkëtueshmet nga risiguresit	8,176		8,176
Risigurimet me vlerësim > = BBB	8,176	Pa limituara	8,176
Risigurimet me vlerësim <BBB	-	25%	-
Pjesa e risiguriesve në provizionet teknike	25,321		25,321
Risigurimet me vlerësim > = BBB	25,321	Pa limituara	25,321
Risigurimet me vlerësim <BBB	-	25%	-
Interesi i përlllogaritur nga investimet	-	5%	-
Të arkëtueshmet e sigurimit, jo më të vjetra se 90 ditë	89,913	Limituara deri në 20% të UPR	44,179
Nga mbajtësit e policave	89,913		89,913
Nga ndërmjetësuesit	-		-
Pasuritë fike tjera , që nuk përfshihen në pikën 3.	-		-
Gjithsej pasuritë që mbulojnë provizionet teknike	6,864,367		6,273,934

Table 5: Mbulueshmëria e Provizioneve teknike

Provizionet teknike më 31 dhjetor 2018	Shuma
Provizioni për primin e pa fituar dhe riskun e pa skaduar	220,894
Provizioni për dëmet dhe rezervën matematikore	5,772,482
Provizione teknike të tjera	33,613
Gjithsej shume e kërkuar për të mbuluar provizionin teknik	6,026,988
Pasuritë që mbulojnë provizionin teknik	6,273,934
Gjithsej provizioni teknik	6,026,988
Diferenca	(246,946)
Niveli i mbulueshmërisë	104%